

OFERTË REFERENCË AKSESI NË RRJETIN LOKAL TË ONE ALBANIA (RUO)

Janar 2023

(Përditësuar sipas VKD Nr. 2702 dhe 2704, date 22.12.2016 dhe VKD Nr. 13, date 04.05.2017; si
dhe Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP nr.14, datë 07.11.2022)

PËRMBAJTJA

1. PJESA E PËRGJITHSHME
2. ANEKS A: PËRKUFIZIMET
3. ANEKS B: FATURIMET DHE PAGESAT
4. ANEKS C: SKEDAT E SHËRBIMEVE
 - a. SKEDA E SHËRBIMIT 101
 - b. SKEDA E SHËRBIMIT 102
 - c. SKEDA E SHËRBIMIT 103
 - d. SKEDA E SHËRBIMIT 104
5. ANEKS D: LISTA E ÇMIMEVE PËR SHËRBIMET E AKSESIT LLU
(Bashkëngjitur dokument më vete)
6. ANEKSI E – MARRËVESHJA E NIVELIT TË SHËRBIMIT.
7. ANEKSI F - LISTA E PIKAVE TË AKSESIT NË RRJETIN ONE ALBANIA KU OFROHET
BASHKËVENDOSJE FIZIKE
8. MANUALI I PROÇESEVE PËR SHËRBIMET E ONE ALBANIA: SHËRBIMET E AKSESIT LLU
(bashkëngjitur dokument më vete)
9. LISTA E ÇMIMEVE PËR AKSESIN NË TUBACIONE
(Bashkëngjitur dokument më vete)

RUO
PJESA E PËRGJITHSHME

1. Kuadri Ligjor

Dispozitat e kësaj Oferte Reference Aksesi janë hartuar në përputhje me:

- Ligjin Nr.9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me Ligjin nr.102/2012; (ketej e tutje”Ligji 9918”);
- Rregulloren nr.19, date 14.06.2010 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin” miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 1300, datë 14.06.2010, i ndryshuar (këtej e tutje ‘Rregullorja e Aksesit dhe Interkoneksionit’).
- Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP, Nr. 2702 datë 22.12.2016, që ka përcaktuar Albtelecom sipërmarrës me Fuqi të Ndjeshme në Treg për tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe linjat me qera dhe masat përkatëse rregulluese”
- Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP, Nr 2703, date 22.12.2016, per “Miratimin e Dokumentit: Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT ne tregjet me shumice te aksesit broadband dhe në infrastrukturën aktive dhe pasive në rrjete fikse- Dokumenti Perfundimtar”
- Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP, Nr 2704, date 22.12.2016, per “Rregullimin e tarifave të sipërmarrësit Albtelecom Sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg për tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe linjat me qira”
- Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP, Nr.13, date 04.05.2017 per “Shqyrtimin e ankimit administrativ te sipermarresit Albtelecom Sh.A per vendimet e Keshillit Drejtues te AKEP me nr. 2703 dhe nr. 2704, date 22.12.2016.
- Rregulloren nr 16, date 16.04.2010 “Për treguesit e cilësise” miratuar me VKD 1256, datë 16.04.2010;
- Rregulloren nr. 18, date 11.06.2010 “Për procedurat e zgjidhjes se mosmarrëveshjeve, miratuar me VKD nr 1296, datë 11.06.2010;
- Rregulloren “Për Autorizimin e Përgjithshëm” me nr.24, datë 02.02.2012;
- Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr.14, datë 07.11.2022 *“Për miratimin e transferimit të të drejtave të përdorimit të frekuencave të dhëna sipas regjimit të Autorizimit Individual dhe regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm si dhe për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara në aktet rregullatore të nxjerra nga AKEP nga sipërmarrësi ALBtelecom sh.a te sipërmarrësi One Telecommunications sh.a”*

si dhe çdo akt tjetër normativ të nxjerrë nga AKEP me ndikim në këtë Ofertë Referencë të Aksesit për LLU.

Meqënëse:

- a) Operatori përfitues i aksesit zotëron Çertifikaten e Konfirmimit të Njoftimit lëshuar nga AKEP në përputhje me Rregulloren “Për Autorizimin e Përgjithshëm”, me Nr. 24, datë 02.02.2012, për të ofruar rrjete/shërbime te komunikimeve elektronike në përputhje me Ligjin nr. 9918 dt. 19.05.2008.
- b) ONE Albania është përcaktuar nga AKEP me VKD Nr. 2702, datë 22.12.2016 sipërmarrës Fuqi të

Ndjeshme në Treg për tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe linjat me qera dhe masat përkatëse rregulluese” dhe zotëron Çertifikatën e Konfirmimit të Njoftimit lëshuar nga AKEP në përputhje me Rregulloren “Për Autorizimin e Përgjithshëm”, me Nr.24, datë 02.02.2012

- c) ONE Albania ka rënë dakort të ofrojë akses në rrjetin e tij, në përputhje me legjislacionin kombëtar si dhe duke marrë në konsideratë udhëzimet dhe rekomandimet ndërkombëtare mbi aksesin për përdorim të përbashkët të rrjetit lokal LLU të Komisionit Europian (KE) si dhe ka rënë dakort për ofrimin e shërbimeve dhe fasiliteve sipas kushteve dhe termave të dhëna në këtë marrëveshje (Rregulloret).
- d) Objekt i kuadrit ligjor dhe rregullator të cituar, palët pranojnë se marrëveshja e Aksesit do të përcaktojë termat dhe kushtet e aksesit të plotë në rrjetin lokal (full LLU) dhe aksesin përbashkët në rrjetin lokal (shared access LLU), brenda ambienteve të ONE Albania (ish centralet telefonike të ONE Albania), për sa kohë do të ketë ende pika të tilla sipas përditësimit të Aneksit F, pika 1, si dhe në MSAN-e (infrastrukturë e jashtme e rrjetit ONE Albania) nëpërmjet të cilës përfituesi i aksesit mund të kërkojë bashkëvendosje fizike nga ONE Albania për të bërë të mundur ofrimin e shërbimeve nga operatori përfitues.

Në përputhje me angazhimet dhe detyrimet reciproke që përmban kjo marrëveshje, palët më sipër bien dakort si më poshtë:

2. Përkufizime dhe Interpretime

- 2.1. Në këtë marrëveshje, përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe, fjalët dhe shprehjet kanë kuptimin e përcaktuar në Aneks A.
- 2.2. Referencat që i bëhet akteve ligjore, nënligjore dhe rregullatore i referohen këtij legjislacioni si dhe çdo amendimi të mundshëm, apo akteve nënligjore të dala në plotësim të këtij legjislacioni.
- 2.3. Termat e përcaktuara në aktet ligjore dhe rregullatore shqiptare, nëse janë përdorur në këtë Ofertë Referencë do të kenë të njëjtin kuptim sipas atyre akteve ligjore.
- 2.4. Pa cënuar të drejtat e ONE Albania, në rast të një mosmarrëveshje apo paqartësie mes termave të përcaktuara në ligjet dhe rregulloret e zbatueshme në lidhje me këtë Ofertë Referencë, do të zbatohet rendi i mëposhtëm i përparësisë:
- Ligji për Komunikimet Elektronike në Republikën Shqipërisë
 - Rregullorja për Aksesin dhe Interkoneksionin e AKEP

3. Vlefshmëria dhe afati

3.1. Kjo marrëveshje i fillon efektet e saj në datën e përcaktuar dhe do të vazhdojë deri:

3.1.1. Në kohën që Operatorit i mbaron afati i autorizimit, i revokohet autorizimi dhe Operatori nuk ka

marrë autorizim tjetër zëvendësues për ofrimin e rrjetit dhe ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.

3.1.2. Në kohën që ONE Albania i mbaron afati i autorizimit, i revokohet autorizimi dhe ONE Albania nuk ka marrë autorizim tjetër zëvendësues për ofrimin e rrjetit dhe ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.

3.1.3. Zgjidhjen e marrëveshjes sipas përcaktimeve të kësaj RUO dhe Marrëveshjes së lidhur mes palëve, përfshire midis të tjerave, mos-ndryshimin apo mos-rinovimin e garancisë financiare sipas përcaktimeve në nenet 20 dhe 21.

4. Shërbimet e Aksesit

4.1. Shërbimet e aksesit do të ofrohen sipas përcaktimeve në Skedarin përkatës të shërbimeve në Aneks C të kësaj Marrëveshjeje Aksesit.

4.2. Detyrimet financiare për ofrimin, operimin dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të çdo shërbimi aksesit për palën përfituese do të jenë në përputhje me çmimet apo parimet e faturimit të përcaktuara në Listën e çmimeve.

4.3. Periudha standarte e lëvrimin për shërbimet e aksesit do të jetë sipas përcaktimeve në Skedarin e Shërbimeve të kësaj Marrëveshjeje Aksesit. Nëse do të jetë e nevojshme ndonjë ndryshim nga periudha standarte në lidhje me shërbimin e aksesit apo vendin, ONE Albania do të përcaktojë këtë ndryshim në ofertën për vendin në lidhje me atë vend.

4.4. Për evitimin e çdo dyshimi dhe pavarishtë nga shërbimi i aksesit të ofruar operatorit përfitues, ONE Albania nuk do të ketë asnjë detyrim ndaj përfituesit të aksesit për të ofruar një shërbim tjetër aksesit përveç atyre të përcaktuara sipas kësaj marrëveshjeje aksesit.

5. Tarifat për shërbimet e aksesit

5.1. Tarifat që rezultojnë për çdo shërbim përshkruhen në detaje në Listën e çmimeve të RUO-s të ONE Albania. Në lidhje me tarifatat për porositë, këto do të jepen në lidhje me vendin në momentin e dhënies së ofertës për vendin.

5.2. Përfituesi (Kërkuesi) i aksesit¹ do të jetë përgjegjës për pagesat ndaj ONE Albania në fazën e porosisë (ordering) në përputhje me termat e kësaj marrëveshjeje në lidhje me bashkëvendosjen fizike.

5.3. Përfituesi i aksesit do të jetë gjithashtu përgjegjës për të gjitha pagesat sipas përcaktimeve në Marrëveshjen e aksesit, kur është e aplikueshme, për çdo vend që ofrohet bashkëvendosja fizike.

5.4. Metoda e rishikimit të tarifave përshkruhet në nenin 16, “Rishikimi” dhe është gjithashtu e përcaktuar në Marrëveshjen e Aksesit në lidhje me çdo vend.

¹ Termat *Përfituesi i aksesit* dhe *Kërkuesi i Aksesit* kanë të njëjtin kuptim në të gjithë tekstin e RUO.

6. Regjistrimi i ofrimit të shërbimeve të aksesit

- 6.1. Përgjegjësia për të regjistruar ofrimin e shërbimeve të skeduar dhe Marrëveshjeve të Aksesit do të mbetet ONE Albania.
- 6.2. ONE Albania do të sigurojë që metodat e tij të regjistrimit dhe dispozitat përkatëse të jenë mjaftueshmërisht të detajuara për të bërë të mundur plotësimin e detyrimeve të tij siç është përcaktuar në pikën 6.1 më sipër.

7. Faturimi dhe Pagesat

- 7.1. Përfituesi i aksesit do të jetë përgjegjës për të gjitha pagesat e lëshuara nga ONE Albania në lidhje me ofrimin e shërbimeve në përputhje me këtë RUO dhe Marrëveshjes së Aksesit
- 7.2. Detyrimet për faturimin dhe pagesat do të jenë sipas përcaktimeve në Aneks B.
- 7.3. Tarifat në Marrëveshjen e Aksesit bazuar në këtë Ofertë Referencë Aksesit nuk përfshijnë TVSH. TVSH do të tarifohet në faturat që lëshohen në zbatim të kësaj Ofertë Referencë të Aksesit kur një gjë e tillë parashikohet nga Ligji për TVSH në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- 7.4. Faturat janë të pagueshme në Lekë. Ato lëshohen sipas legjislacionit në fuqi.

8. Siguria e personelit dhe instalimeve/Ruajta e integritetit të Rrjetit

- 8.1. Secila Palë do të garantojë funksionimin e sigurt të rrjetit të saj dhe do të ndërmarr çdo masë të nevojshme dhe të arsyeshme për zbatimin e Aksesit sipas kësaj Oferte Referencë të Aksesit (RUO), në mënyrë që të sigurojë se rrjeti:
 - a) Nuk përbën asnjë rrezik për sigurinë e shëndetit të personelit dhe klienteve të vet apo të Palës tjetër, dhe
 - b) Nuk sjell demtime, interferenca apo defekte në funksionimin e rrjetit të Palës tjetër.
- 8.2. Asnjë nga palët nuk do të lidhë apo do të lejojë me dijeni lidhjen në rrjetin e tij të ndonjë paisjeje, aparati, përfshirë por jo vetëm, me asnjë paisje terminimi që nuk është aprovuar, në përputhje kjo me Ligjin 9918 dhe Rregulloren nr.25 dt.14.06.2012 'Për paisjet radio dhe fundore të telekomunikacioneve dhe njohjen e konformitetit të tyre' e AKEP.

9. Cilësia e Shërbimit

- 9.1. Palët do të bëjnë përpjekjet e tyre maksimale për të arritur zbatimin e specifikimeve sipas Manualit të Proçeseve ndërmjet operatorëve dhe Planit të Menaxhimit të Frekuencave të linjës dypërcjellëse të bakrit të ONE Albania, bashkëlidhur këtij dokumenti. Çdo kërkesë tjetër e cila mund të imponohet në lidhje me një Marrëveshje Aksesit do të kërkojë gjithashtu dakortësinë e palëve.

10. Ofrimi, operimi dhe mirëmbajtja

10.1. Proçedurat për instalimin fillestar dhe testimin e ndonjë pajisjeje në lidhje me ndonjë shërbim aksesi, si dhe për operimin dhe mirëmbajtjen e vazhduar, do të mbështeten në parashikimet e Manualit të proceseve ndërmjet operatorëve siç specifikohet në nenin 9.1 - Cilësia e Shërbimit. Në lidhje me bashkëvendosjen fizike, kërkesat në lidhje me instalimin, testimin, operimin dhe mirëmbajtjen do të jenë gjithashtu të përcaktuara në Marrëveshjen e Aksesit ku përfituesi i aksesit është i detyruar të zbatojë këto kërkesa.

11. Dhënia e informacionit

- 11.1. Në përputhje dhe me nenin 14 (Ruajtja e konfidencialitetit) të Marrëveshjes së Aksesit bazuar në këtë Ofertë Referencë, njëra palë mund të kërkojë palës tjetër informacion mbi protokollet në përdorim nga pala tjetër, informacion i cili është i nevojshëm për Aksesin, sigurimin e shërbimeve të pershkuara në marrëveshjen e aksesit bazuar në këtë Ofertë Referencë, gjithmonë nëse pala tjetër ka informacion të nevojshëm dhe nëse sigurimi i këtij informacioni është i domosdoshëm si pasojë e mungesës dhe/ose pamjaftueshmërisë të standarteve ndërkombëtare apo atyre të miratuara nga AKEP.
- 11.2. Pavarësisht detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja e aksesit bazuar në këtë Ofertë Referencë, asnjë nga palët nuk do jetë e detyruar të sigurojë informacion i cili është subjekt konfidencialiteti i detyrimeve ndaj një pale të tretë, përveçse kur kjo e fundit ka dhënë miratimin për një gjë të tillë.
- 11.3. Pala dhënëse e informacionit do të bëjë të gjithë përpjekjet e arsyeshme që të sigurohet se informacioni i dhënë është më i sakti i mundshëm sipas njohurive të saj, në momentin e dhënies së tij.
- 11.4. Nëse pala dhënëse i jep informacion palës marrëse, atëherë pala dhënëse do të marrë paraprakisht të gjithë miratimet e nevojshme nga palët e treta.
- 11.5. Pala marrëse e informacionit do të dëmshpërblejë palën dhënëse dhe do ta mbajë atë të indentifikuar kundrejt të gjithë përgjegjësive, padive, kërkesave, dëmeve të pretenduara, kostove apo shpenzimeve që kanë lindur si pasojë e dështimit nga ana e palës marrëse për të vepruar në përputhshmëri me kushtet e vëna, përfshirë ato të përmendura në nenin 14 (Ruajtja e konfidencialitetit) të Marrëveshjes së Aksesit, nga pala dhënëse apo nga ndonjë palë e tretë në momentin që informacioni është dhënë.
- 11.6. Për të shmangur çdo dyshim, asgjë në marrëveshjen e aksesit bazuar në këtë Ofertë Referencë, nuk do mund të detyrojë dot ndonjë nga palët që të veprojë në kundërshtim me detyrimet ligjore dhe rregullatore të mbrojtjes së të dhënave.

12. Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve të Aksesit

- 12.1. Kjo dispozitë nuk do të jetë e zbatueshme për mosmarrëveshje që rrjedhin në lidhje me rastet kur ndonje nga palet deshton të kryejë pagesat e shërbimeve ose në rastet e kryerjes së Shkeljeve Materiale, të cituara në pikën 13.2.1 më poshtë.
- 12.2. Siç parashikohet në nenin 12.1 më sipër, secila nga palët do të bëjë përpjekjet në më të mirën e mundshme për të zgjidhur mosmarrëveshjet që lindin si rrjedhojë e implementimit, aplikimit apo interpretimit të kësaj marrëveshjeje duke filluar si fillim në negociata mes palëve nëpërmjet kontakteve normal. Kjo fazë e mosmarrëveshjes do të referohet si “Niveli I”.
- 12.3. Në rast se palët dështojnë të zgjidhin mosmarrëveshjen në Nivelin I të negociatave brenda 2 javëve, secila nga palët do të ketë të drejtën të fillojë procedurat për zgjidhje mosmarrëveshje të specifikuara në këtë mënyrë në “njoftimin për zgjidhje mosmarrëveshje” që i dërgohet palës tjetër. Pala që lëshon njoftimin (Pala që kërkon zgjidhjen e mosmarrëveshjes) do të përfshijë në njoftimin për zgjidhje

mosmarrëveshje të gjitha detajet përkatëse përfshirë natyrën dhe masën e mosmarrëveshjes.

- 12.4. Njoftimi për zgjidhje mosmarrëveshje do të përbëjë kalimin në Nivelin 2. Niveli 2 konsiston në konsultimet mes palëve në mirëbesim për të zgjidhur mosmarrëveshjen.
- 12.5. Nëse përpjekjet e palëve për të zgjidhur mosmarrëveshjen në Nivelin 2 nuk janë të suksesshme brenda 2 javëve, secila nga palët, nëpërmjet njoftimit për mosmarrëveshje (niveli 3 “Njoftimi” drejtuar palës tjetër ka të drejtë, të kalojë mosmarrëveshjen për zgjidhje në AKEP, referuar si Niveli 3. Njoftimi i Nivelit 3 do t’i dërgohet AKEP dhe Palës tjetër. Njoftimi i Nivelit 3 do të përfshijë të gjitha detajet lidhur me mosmarrëveshjen bashkë me paraqitje e provave nga të dyja palët për natyrën dhe masën e mosmarrëveshjes.
- 12.6. Kontakti normal për Ofruesin është:

Niveli 1: _____ (pozicioni)

Adresa:

Niveli 2: _____ (pozicioni)

Adresa:

Kontakti normal për Përfituesin e Aksesit është:

Niveli 1: _____ (pozicioni)

Adresa:

Niveli 2: _____ (pozicioni)

Adresa:

Palët janë të detyruar të njoftojnë njëri-tjetrin në vijim të nenit 22 në rastin e ndonjë ndryshimi të pikave respektive.

- 12.7. Kufijtë kohor specifikuar në paragrafët 12.3 dhe 12.5 më sipër mund të shtyhen me marrëveshje të përbashkët mes palëve.
- 12.8. Procedurat e mësipërme janë pa paragjykuar ndonjë të drejtë dhe kompesim që mund të jenë në dispozicion të palëve në lidhje me ndonjë shkelje apo dispozitë të kësaj marrëveshjeje.
- 12.9. Asnjë term i përfshirë këtu nuk do të ndalojë palën që automatikisht të referojë mosmarrëveshjen tek Autoriteti Rregullator pa kaluar në Nivelin 1 dhe Nivelin 2 të negociatave në përputhje me cdo të drejtë që mund të ketë secila palë për të kërkuar një vendim apo hapa të tjera të duhur për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Pa paragjykuar më sipër secila nga palët merr përsipër të përdorë procedurat e Nivelit 1 dhe Nivelit 2 të përcaktuara këtu përpara se ta referojnë mosmarrëveshjen në Autoritetin rregullator (AKEP) përveçse në rrethana përjashtuese (të vecanta)
- 12.10. Çdo mosmarrëveshje apo kërkesë që rrjedh në lidhje me parimet (procedurat) e Pagesave të kësaj marrëveshjeje apo faturave të lëshuara nga ONE Albania për përfituesin e aksesit do të jenë objekt i parashikimeve për zgjidhje mosmarrëveshjeje sipas këtij neni.
- 12.11. Kur një mosmarrëveshje lind si rrjedhojë e një shume të pagueshme në lidhje me një faturë, atëherë

përfituesi i aksesit do të paguajë shumën e detyruar sipas faturës së leshuar nga ONE Albania dhe në të njëjtën kohë përfituesi i aksesit ka të drejtë të fillojë procedurën për zgjidhje mosmarrëveshje brenda periudhës që mund të paguhet rregullisht fatura. Nëse rezulton se përfituesi i aksesit ka të drejtë në pretendimet e tij, ONE Albania do të reflektojë korrigjimet përkatëse në faturën e muajit pasardhës.

12.12. Çdo pretendim në lidhje me shumat e detyrimeve do të konsiderohet i vlefshëm vetëm në rast se ky pretendim ngrihet brenda afateve ligjore të parashikuara në legjislacionin përkatës.

13. Përfundimi i Marrëveshjes së Aksesit

13.1. Në rast se ndonjë nga palët është në shkelje të ndonjë termi apo parashikimi të kësaj marrëveshjeje, atëherë pala jo në shkelje do t'i dërgojë një njoftim me shkrim palës në shkelje, duke i specifikuar shkeljen për të cilën ankohet dhe duke i dhënë palës në shkelje brenda një periudhe kohë që mendohet të arsyeshme ndreqjen e çështjes për të cilën është ankuar (kjo kohë e arsyeshme nuk mund të jetë më pak se 1 muaj).

13.2. Nëse shkelja është materiale dhe pala në shkelje do të dështojë apo neglizhojë në zgjidhjen e problemit, brenda periudhës së kohës së përmendur më lart, për të ndrequr çështjen e përmendur pala jo në shkelje do të mundet të përfundojë këtë marrëveshje pa njoftim të mëtejshëm, duke njoftuar me shkrim AKEP.

13.2.1. Shkelje materiale do të përfshijë:

- a) Operatori përfitues ose stafi i tij ndërhyjnë (interferojnë me) ose përdorin pajisje të ONE Albania ose operatorëve të tjerë në ambientet e bashkëvendosjes, përveç pajisjeve të aktivizimit të alarmit, fikësve të zjarrit ose ndonjë pajisje tjetër që i përkasin ONE Albania dhe për të cilat kanë marrë leje përdorimi nga ONE Albania;
- b) Operatori përfitues ose stafi i tij aksesojnë Ambientet ose centralin telefonik të ONE Albania ose kryejnë ndryshime fizike ose ndryshime fizike të parashikuara pa lejen e ONE Albania;
- c) Veprime të operatorit përfitues ose stafit të tij ndikon negativisht në funksionimin normal dhe eficient të rrjetit të ONE Albania, ose paraqet rrezik për sigurinë e ndonjë personi.

13.3. Një palë do të mundë të përfundojë këtë marrëveshje duke njoftuar me shkrim nëse ndodhet në një nga kushtet e mëposhtme:

- i. Likuidimin e vullnetshëm ose të detyruar (përveç se për qëllime riorganizimi ose bashkimi të bizneseve); ose është deklaruar në falimentim,
- ii. Është i paaftë të paguajë borxhet në zbatim të legjislacionit për shoqëritë tregtare.
- iii. Hyn në një angazhim vullnetar me kreditorë sipas legjislacionit për shoqëritë tregtare.
- iv. Përfundimit të afatit, anulimi dhe raste të tjera të përfundimit të parakohshëm të licencës ose autorizimit, kur një licensë ose autorizim i tillë kërkohet me ligj.
- v. Operatori përfitues ka kryer katër shkelje të pagesave në afat brenda një viti kalendarik, në lidhje me shumat e detyruara, përveç parashikimit në nenin 12-zgjidhja e Mosmarrëveshjes,
- vi. Operatori përfitues ndodhet në kushtet e mos-ndryshimit apo mos-rinovimit të garancisë financiare sipas përcaktimeve në seksionin 18 'Garancia Financiare'.

13.4. Parashikimet e ONE Albania për shërbimet e aksesit bazohen në kuadrin dhe detyrimet rregullatore në fuqi në kohën e ekzekutimit të marrëveshjes. Në rast të ndonjë ndryshimi në kuadrin dhe detyrimet

rregullatore mbi të cilën ONE Albania ofron shërbimet e aksesit, ONE Albania i lind e drejta të kërkojë menjëherë një rishikim të termave dhe kushteve të kësaj marrëveshjeje për ato shërbime/produkte që nuk janë me objekt i detyrimeve rregullatore duke derguar një njoftim me shkrim 3 muaj përpara datës së bërjes efektive të rishikimit. Përfituesi i aksesit merr përsipër dhe pranon që në rast të një kërkesë të tillë të ONE Albania, përfituesi i aksesit do të angazhohet së bashku me ONE Albania me qëllimin për të negociuar ndonjë amendim të nevojshëm në lidhje me keto shërbime/Produkte. Në rast se negociatat nuk janë të suksesshme secila nga palët mund ta dërgojë mosmarrëveshjen për zgjidhje në AKEP. Aktet rregullatore në lidhje me tarifatat për ofrimin e këtyre shërbimeve sipas kësaj oferte do të konsiderohen automatikisht si pjesë e marrëveshjes së aksesit dhe me efekte që nga data e përcaktuar nga AKEP për hyrjen në fuqi të tyre.

14. Konfidencialiteti

- 14.1. Për zbatimin e marrëveshjes aksesit sipas kësaj Oferte Referencë (RUO), palët do të mbajnë Informacionin Konfidencial kur jepet si “i tillë” dhe do angazhohen që stafi dhe drejtuesit, punonjësit, e agjentet do të informohen për rëndësinë e ruajtjes së informacionit dhe nuk do t’ja mundësojnë këtë informacion palëve të treta.
- 14.2. Operatori Përfitues do të angazhohet si dhe do sigurojë ONE Albania që të dhënat dhe/ose informacioni nuk do disponohet nga persona të pa kualifikuar ose jo ekspert që mund ti transformojnë ose të keqinterpretojnë informacionin ose të dhënat e ofruara nga ONE Albania.
- 14.3. Pala që disponon Informacion Konfidencial do të kufizojë përmbajtjen e të dhënave për personat që për nga natyra e punës duhet të njihen me përmbajtjen e Informacionit Konfidencial. Informacioni Konfidencial do të përdoret në masën e nevojshme vetëm për qëllimin e lidhjes dhe zbatimit të marrëveshjes së aksesit për shërbimet e ofruara te LLU nga ONE Albania.
- 14.4. Çdo palë mund të japë informacion i cili në të kundërt do të ishte konfidencial nëse dhe në masën:
 - a) Kur kërkohet kështu nga Ligji, ose organ qeveritar apo rregullator ndaj të cilit është subjekt ku do që të ndodhet, si dhe është konsultuar me palët e tjera dhe i ka dhënë atyre mundësinë për të kundërshtuar dhënien e informacionit apo ndryshe të ketë rënë dakord për kohën që ky informacion do konsiderohet si jo- konfidencial.
 - b) Çdo palë me të cilën lidhet ky informacion ka dhënë aprovimin e tij me shkrim
 - c) Është në zotërim të publikut përveçse në shkelje të kësaj marrëveshjeje.
 - d) Është apo bëhet e disponueshme për publikun jo për faj të përfituesit të Aksesit.
 - e) Kërkohet të jepet ky informacion nga një organ rregullator qeveritar, gjykatë apo çdo autoritet tjetër me juridiksionin kompetent.
- 14.5. Për qëllim të marrëveshjes së interkoneksionit nëqoftëse njëra nga palët ndodhet para faktit të publikimit të dhënave sipas pikave 14.c dhe 14.a duhet të njoftojë sa më shpejt të jetë e mundur përfaqësuesit e Palës tjetër
- 14.6. Në çdo rast, palët janë të detyruara do të vazhdojnë të respektojnë kushtet e konfidencialitetit sipas këtij neni deri në 5 (pesë) vjet pas përfundimit ose ndërprerjes së njëanshme të saj.

15. Të drejtat e pasurisë intelektuale

- 15.1. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në Marrëveshjen e Aksesit bazuar në këtë Ofertë Referencë, të Drejtat e Pasurisë Intelektuale do t’i mbeten Palës që ka krijuar ose zotëron çfarëdo lloj materiali sipas kësaj Oferte Referencë dhe asnjë dispozitë e Marrëveshjes së Aksesit nuk do të autorizojë ndonjë

kalim të së drejtës së pronësisë, liçensës apo ndonjë të drejtë tjetër në lidhje me Pasurinë Intelektuale nga njëra Palë tek tjetra, dhe asnjë dispozitë e Marrëveshjes së Aksesit nuk do të kufizojë të drejtat e asnjërit prej Operatorëve të Liçensuar për të zotëruar, përdorur, liçensuar, atribuar ose transferuar Pasurinë e tyre Intelektuale.

16. Rishikimi i MA

16.1. Pala mund të kërkojë të amendojë këtë marrëveshje duke i dërguar palës tjetër një njoftim për rishikim nëse:

16.1.1. Autorizimi i secilës nga Palët ndryshon materialisht (amendim apo zëvendësim), ose

16.1.2. Ndodh një ndryshim material në ligj ose aktet normative në fuqi në Shqipëri),ose

16.1.3. Kjo marrëveshje parashikon shprehimisht rishikimin ose palët bien dakort me shkrim që do të ketë një rishikim

16.1.4. Ndodh një ndryshim material, përfshirë masa detyruese nga ndonjë organ rregullator, e cila ndikon ose në mënyrë të arësyeshme mund të pritet të ketë efekt në bazat komerciale ose teknike të kësaj marrëveshjeje, ose

16.1.5. Ndodh një rishikim i përgjithshëm në përputhje me nenin 16.3

16.2. Një njoftim për rishikim do të përcaktojë në detaje të arësyeshme çështjet për tu diskutuar mes palëve.

16.3. Përveç parashikimeve në Marrëveshjen e aksesit, secila pale mund të iniciojë një rishikim të përgjithshëm të kësaj marrëveshjeje të paktën njëherë përgjatë periudhës 12 mujore duke filluar nga data e fillimit të efekteve të kësaj marrëveshjeje dhe vitet më pas. Megjithatë, nese njëra nga palët zbaton nenin 16.2, rishikimi mund të iniciohet siç mund të konsiderohet e përshtatshme nga secila palë që dërgon një njoftim për rishikim.

16.4. Në funksion të njoftimit për rishikim, palët do të negociojnë menjëherë në mirëbesim të çështjeve për tu zgjidhur në këndvështrimin për të rënë dakort për amendamentet përkatëse të kësaj marrëveshjeje.

16.5. Për mënjanimin e çdo dyshimi, palët bien dakort që pavarësisht njoftimit për rishikim kjo ofertë do të mbetet në fuqi dhe me efekte të plota.

16.6. Nëse palët dështojnë të arrijnë një marrëveshje për çështjen subjekt i njoftimit për rishikim brenda 3 muajve kalendarik (periudha përkatëse) në çdo rast nga data e dërgimit të njoftimit për rishikim, secila nga Palët mundet që jo më vonë se 1 muaj nga përfundimi i periudhës përkatëse, të kërkojë me shkrim tek AKEP të vendosë:

16.6.1. Mbi çështjet mbi të cilat palët kanë dështuar të bien dakort

16.6.2. Nëse kjo marrëveshje duhet të modifikohet për të marrë parasysh këto çështje, dhe nëse kështu:

16.6.3. Amendamentin apo amendamentet që duhen bërë

Palët do të hyjnë në një marrëveshje për të modifikuar apo zëvendësuar këtë marrëveshje në përputhje me çfarë është rënë dakort mes palëve për të qenë në përputhje me vendimin e AKEP.

17. Forca Madhore

17.1. As ONE Albania dhe as Operatori Përfitues nuk do të konsiderohen përgjegjës për ndonjë shkelje të Marrëveshjes bazuar në këtë Ofertë Referencë shkaktuar kjo nga “Forcat madhore”. Për këtë arsye “Force madhore” do të kuptohet çdo ngjarje apo ndodhi përtej kontrollit të arsyeshëm të palëve, përfshirë këtu por pa u limituar në kryengritje ose trazira civile, luftra ose ndërhyrje ushtarake, situata të

jashtëzakonshme në shkallë kombëtare ose lokale, marrje masash ose mungesa e tyre nga Qeveria, organi kompetent i qarkullimit rrugor ose organe të tjera kompetente, ndonjë akt i nxjerrë nga Qeveria ose ndonjë autoritet tjetër, zbatimi i ligjit, rregulloreve ose urdhërat e Qeverisë ose ndonjë institucioni qeveritar, mosmarrëveshje industriale të çfarëdolloji (qofshin ato të lidhura ose jo me ONE Albania ose Operatorin Përfitues), zjarret, rrufetë, shpërthimet, përmytjet, tërmetet, rrëshqitjet e dheut, kushte atmosferike të jashtëzakonshme, veprime ose mosveprime të personave për të cilët asnjëra nga palët nuk është përgjegjës, ose ndonjë shkak tjetër i ngjashëm apo i ndryshëm, jashtë kontrollit të tyre të arsyeshëm, me kusht që këto shkaqe ose rrethanat të jenë klasifikuar si forca madhore. Pala e afektuar do të lirohet nga përgjegjësia për dështimin e zbatimit të këtyre detyrimeve nën Marrëveshjen e Aksesit vetëm në masën që e kërkojnë rrethanat.

- 17.2. Pala e afektuar do të njoftojë menjëherë palën tjetër për masën dhe kohën e vlerësuar për këtë paaftësi për të zbatuar detyrimet e tij dhe me pushimin e ngjarjes së Forcës Madhore pala e afektuar do të njoftojë palën tjetër për këtë pushim.
- 17.3. Secila nga palët do të bëjë përpjekjet e tij (i) për të evituar ose hequr rrethanat që përbëjnë Forcën Madhore dhe (ii) të zbusë efektet e Forcës madhore sic dhe kur ajo ekziston.

18. Garancia Financiare

- 18.1. Ky është një kusht që paraprind këtë marrëveshje sipas të cilit përfituesi i aksesit do t'i mundësojë ONE Albania një garanci financiare e cila duhet të jetë lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë në Shqipëri. Vlera e Garancisë do të jetë një vlerë të cilën ONE Albania në opinionin e tij të drejtë dhe të arsyeshëm do ta konsiderojë të përshtatshme si siguri proporcionale kundër moszbatimit ose mosrespektimit të ndonjë prej parashikimeve të këtushme (përfshirë pa kufizim dështimin për të kryer pagesat) nga përfituesi i aksesit, për sa kohë nuk është rënë dakort me shkrim ndryshe me ONE Albania.
- 18.2. Asnjë shërbim nuk do të aktivizohet, implementohet apo do të kryhen punime në lidhje me shërbimet e kërkuara në rast se nuk depozitohet garancia financiare brënda afatit të përcaktuar.
- 18.3. ONE Albania mundet në çdo kohë, t'i kërkojë përfituesit të aksesit të vendosë në banke ose garanci të tjera ose të ofrojë ndonjë formë tjetër të sigurisë financiare (psh një depozitë) e cila në opinionin e drejtë dhe të arsyeshëm të ONE Albania është/janë të përshtatshme si siguri proporcionale kundër moszbatimit ose mosrespektimit të ndonjë prej parashikimeve e këtushme (përfshirë pa kufizim dështimin për të kryer pagesat) nga përfituesi i aksesit. ONE Albania rezervon të drejtën për të trajtuar refuzimin për të vënë në dispozicion këtë sigurim apo dështim për të ofruar këtë lloj sigurie brënda 30 ditëve (ose periudha më të gjata nëse ONE Albania e sheh të arsyeshme) nga data e kërkesës së ONE Albania si shkelje të Marrëveshjes nga përfituesi i aksesit.
- 18.4. Shuma e Garancisë Financiare do të perlojaritet në mënyrë të tillë që të mbulojë detyrimet e Operatorit Përfitues (për detyrimet mujore dhe jo për pagesat one-off) për një periudhë dy-mujore. Për operatorët që kanë marrë akses vlera e garancisë llogaritet mbi detyrimet e dy muajve të fundit, ndërsa për operatorët e rinj mbi parashikimin për dy muajt në vazhdim. Vlera e garancisë do të rishikohet çdo gjashtë muaj, si dhe në rastet e ndryshimeve të ndjeshme, të cilat konsiderohen ndryshim i detyrimeve të dy muajve të fundit nga vlera e Garancisë Financiare minimalisht në masën 30%.
- 18.5. Vlefshmeria e Garancisë Financiare duhet të jetë për një periudhë minimale një vjecare, duke filluar nga dita e nënshkrimit të Marrëveshjes së aksesit midis palëve, në përputhje me këtë Ofertë Referencë. Një muaj përpara datës së përfundimit të periudhës së vlefshmerisë së garancisë, do të dorëzohet një Garanci Financiare e re. Në momentin e dorëzimit të Garancisë Financiare të re, ONE Albania do t'i kthejë palës tjetër Garancinë Financiare pararendëse. Dështimi për të rinovuar apo

dhënë një garanci të re, i jep ONE Albania të drejtën të ndërpresë ofrimin e shërbimeve sipas marrëveshjes.

- 18.6. Garancia Financiare, do të aktivizohet pjesërisht apo tërësisht në raste mospagese në kohë të detyrimeve të Operatorit përfitues për shërbimet e aksesit të ofruara në përputhje me Marrëveshjen e Aksesit për LLU të lidhur sipas kësaj Oferte Referencë Aksesit.
- 18.7. Pas përdorimit të Garancisë Financiare, ajo do të duhet të rikthehet në shumën e mëparshme ose operatori përfitues duhet të ofrojë një garanci tjetër për të plotësuar apo zëvendësuar garancinë e përdorur, brenda 10 ditëve pune nga përdorimi i garancisë fillestare.

19. Kufizimi i Përgjegjesisë

- 19.1. Asnjë nga palët nuk ka detyrim të asnjë lloji kundrejt palës tjetër, përveç detyrimit për të ushtruar aftësinë e pranueshme dhe kujdesin ndaj operatorit të rrjetit të komunikimeve publike për zbatimin e detyrimeve të tij sipas kësaj marrëveshjeje.
- 19.2. ONE Albania/Operatori Përfitues pranojnë përgjegjësitë në përputhje me detyrimet e përcaktuara në kodin e punës dhe legjislacionin përkatës.
- 19.3. Çdo parashikim i nenit 19 është një kufizim i veçuar që aplikohet dhe qëndron edhe nëse një ose më shumë parashikime të tilla janë të pazbatueshme apo konsiderohen të paarsyeshme në ndonjë rrethanë.

20. Caktimi i të drejtave apo detyrimeve

- 20.1. Përfituesi i aksesit nuk do të lejohet të caktojë plotësisht apo pjesërisht ose të disponojë ndryshe, ndonjë nga të drejtat apo detyrimet e tij të këtushme.

21. Shkrija ose riorganizimi (rindertimi)

- 21.1. Nëse përfituesi i aksesit është një shoqëri tregtare, në rast të riorganizimit apo shkrirjes së biznesit të tij, përfituesi i aksesit duhet të njoftojë me shkrim ONE Albania për ndryshimet e ndodhura. ONE Albania pasi të vlerësojë dhe përditësojë ndryshimet e kryera nga përfituesi i aksesit duhet ta pajisë atë me një Marrëveshje të re Aksesit me të njejtat kushte si MA pararendëse.

22. Njoftimet

- 22.1. Një njoftim do të konsiderohet i dërguar:
 - a) Në kohë e dërgesës, nëse dërgohet personalisht
 - b) 48 orë pas postimit në rast se adresa është brenda Shqipërisë
 - c) 96 orë postimit nga cdo adresë tjetër, ose
 - d) 2 orë pas transmetimit (me marrjen nga dërguesi të një konfirmimi të vleshëm për dërgimin), nëse dërgohet me fax në ditë pune ose përpara orës 3.00 pm ose në cdo rast tjetër në 10.00 am në ditën e punës pas ditës së dërgimit
- 22.2. Nëse koha e konsideruar e shërbimit nuk është gjatë orarit normal të punës të vëndit marrës, njoftimi do të konsiderohet i dërguar ose në rastin e dërgimit me fax, 2 orë pas hapjes së punës në ditën tjetër të punës të atij vëndi.
- 22.3. Parashikimet për shërbimet e konsideruara të përcaktuara në nenin 22.1 më sipër nuk aplikohen tek:

- a) Një njoftim i dërguar me postë nëse ka një pezullim kombëtar apo lokal apo ndërprerje të shërbimeve postare të cilat afektojnë marrjen e njoftimit ose është i tillë që njoftimi në mënyrë të arsyeshme nuk mund të pritët që të mund të dërgohet brenda 48 orëve ose 96 orëve (sic mund të jetë e përshtatshme) pas postimit; dhe
- b) Një njoftim i dërguar me fax, nëse, përpara kohës në të cilën një njoftim do të konsiderohet ndryshe i dërguar, pala marrëse informon palën dërguese që njoftimi është marrë në një formë që është e paqartë në çdo kuptim material, dhe, nëse pas njoftimit të palës dërguese me telefon, gjithashtu njoftohet një fax konfirmues brenda 2 orëve.
- c) Në rast të ndonjë shërbimi personal që është dorëzuar dorazi palës ose dërguar ose dorëzohet në një vënd të përshtatshëm letrash siç ka adresën.
- d) Në rast të një letre të dërguar me postë, që letra të jetë adresuar sic duhet, stampuar dhe postuar; dhe
- e) Në rast të një fax-i që është adresuar siç duhet dhe dërguar në numrin e pales;
- f) Pala nuk do të mundohet të ndalojë ose vonojë funksionimin e një njoftimi të lidhur me këtë Marrëveshje Aksesi.

22.4. Njoftimi për mosmarrëveshje në Nivelin 1 do të dërgohet si më poshtë:

Nëse dërgohet në ONE Albania:

_____ pozicioni

Adresa:

Nëse dërgohet tek kërkuesi i aksesit:

_____ emër mbiemër

Adresa:

Ose në adresa të tjera siç palët mund të njoftojnë kohë pas kohe në përputhje me nenin 26.

Pikat e kontaktit në rast të Kalimit në Nivelin 2 për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë si më poshtë:

Nëse dërgohet në ONE Albania:

_____ pozicioni

Adresa:

Nëse dërgohet tek kërkuesi i aksesit:

_____ emër mbiemër

Adresa:

23. Tërësia e marrëveshjes

23.1. Marrëveshja e Aksesit që do të nënshkruhet në zbatim të kësaj Oferte Reference Aksesi, përfaqëson tërësisht kuptimin dhe interpretimin e palëve në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshje, dhe përveç rasteve kur është rënë dakord me shkrim ndryshe, do të ketë përparësi ndaj të gjithë marrëveshjeve të mëparshme, angazhimeve, detyrimeve, apo përfaqësimeve të çfarëdo lloji, qofshin verbale apo në forme

të shkruar.

24. Heqja dorë

24.1. Heqja dorë nga ndonjë shkelje, ose mospërmbushja e ndonjërit prej afateve dhe kushteve që rrjedhin nga pranimi i kësaj Oferte Referencë nuk do të interpretohen si heqje dorë nga çdo afat dhe/ose kusht tjetër i kësaj Oferte Referencë. Heqja dorë do të jetë e vlefshme vetëm nëse bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga pala që njofton dorëheqjen.

25. Vlefshmëria

25.1. Pavlefshmëria, mungesa e forcës detyruese të ndonjërit prej dispozitave në Marrëveshjen e Aksesit nuk do të ketë asnjë ndikim mbi vlefshmërinë ose forcën detyruese të dispozitave të tjera.

26. Ndryshimet në RUO dhe MA

26.1. Amendamentet dhe shtesat e kësaj Oferte, përfshirë Anekset, Shtojcat dhe Skedarët e Shërbimeve do të jenë të vlefshme nëse janë hartuar me shkrim, të datuara dhe të nënshkruara nga të dyja palët. Të tilla amendamente dhe shtesa nuk do të ndikojnë vlefshmërinë ose forcën e cdo dispozite tjetër të kësaj Oferte.

26.2. Ndryshimet në Listën e Çmimeve të RUO të ONE Albania nuk janë subjekt i kërkesave formale të këtij neni.

26.3. Çdo amendim i RUO përfshirë tarifrat që janë pjesë e saj, të miratuara nga AKEP, do të konsiderohet si pjesë e përfshirë automatikisht në MA midis palëve dhe me efekte nga data e përcaktuar në vendimin e AKEP për miratimin e ndryshimeve.

27. Marrëdhënia mes Palëve

27.1. Marrëdhënia mes palëve është ajo e kontraktorëve të pavarur. Asgjë në këtë marrëveshje nuk do të interpretohet që ta bëjë palën tjetër agjent, sipërmarrës të përbashkët ose partner i apo me palën tjetër. Asnjë prej palëve nuk i jepet ndonjë e drejtë ose agjenci, e shprehur ose nënkuptuar, në emër të palës tjetër, as edhe të lidhë ligjërisht tjetrin në çfarëdo mënyre. Asnjë nga palët nuk do të jetë përgjegjës nëpërmjet ndonjë përfaqësimi, akti apo heqje dorë të tjetrit e cila është në kundërshtim me ose i paautorizuar nga dispozitat e kësaj marrëveshjeje.

28. Ligji i zbatueshëm dhe gjykata kompetente

28.1. Përveçse sa parashikohet në Marrëveshjen e Aksesit, interpretimi, vlefshmëria dhe zbatimi i kësaj marrëveshjeje do të zbatohet në lidhje me të gjitha ligjet e Shqipërisë dhe Palët i nënshtrohen juridiksionit ekskluziv të Gjykatës shqiptare.

ANEKS A

Përkufizimet

Në këtë marrëveshje, fjalët dhe shprehjet kanë kuptimet e mëposhtme:

Marrëveshje Aksesi	Do të thotë kjo marrëveshje
Stafi i kërkuesit të Aksesit	Do të thotë secili punonjës, agjent apo kontraktor i kërkuesit të Aksesit
Shërbimet e Aksesit	Shërbimet të cilat paraqiten ne Aneksin C të kësaj marrëveshje
Raporti i përdorimit të Aksesit	Një matricë bazuar në përdorimin (charges) për secilin shërbim aksesi dhe në dendurinë e përdorimit të këtyre shërbimeve
Aparati	Do të thotë pjesa e paisjes (nese ka te tillë), të cilën ONE Albania lejon që kerkuesi i Aksesit ta instalojë në hapësirën e bashkëvendosjes (Serviced Exchange Footprint) në përputhje me procesin e njoftimit të paisjes siç detajohet në Manualin e Proçeseve midis Operatorëve.
Informacioni i faturimit	Informacioni i cili duhet të bëhet i disponueshëm nga pala faturuese në mbështetje të faturave të lëshuara nën këtë Marrëveshje siç është rënë dakort nga palët, për t'i mundësuar palës së faturuar të pranojë faturën.
Pala faturuese	Ajo palë e cila lëshon cilëndo faturë specifike
Periudha e faturimit (periudha ushtrimore)	Intervalet e rëna dakort për të cilat ndodh faturimi sipas kësaj marrëveshje.
Ditë pune	Do të thotë çdo ditë, përveç të Shtunës dhe të Dielës, në të cilat bankat e nivelit të dytë janë të hapura për veprimtari normale.
Punonjësi i punëve	Një nëpunës i ONE Albania i cili është teknikisht i kualifikuar në mënyrë të përshtatshme dhe që do të shoqërojë Kërkuesin e aksesit në premiset e centraleve të ONE Albania dhe në hapësirën e bashkëvendosjes (Serviced Exchange Footprint) për t'u siguruar që cilado veprimtari e kërkuesit të aksesit nuk do të ndikojë në mënyrë të dëmshme integritetin e rrjetit të ONE Albania dhe/ose të kërkuesve të tjerë të Aksesit, dhe që mekanizmat sipas të cilave veprimtari të tilla kryhen, janë sipas standardeve të përshtatshme dhe deklarimeve të mënyrave (method statement).

Informacioni konfidencial	I gjithë informacioni i cili bëhet i disponueshëm nga secila palë, qoftë verbalisht ose në formë të shkruajtur do të konsiderohet informacion konfidencial përveçse kur është përcaktuar ndryshe pasi në mënyrë më të detajuar kjo qartësohet në Marrëveshjen e Ruajtjes së Konfidencialitetit (Non disclosure Agreement).
Plani menaxhimit të Frekuencave të linjës dypercjellëse të bakrit	Do të thotë plani me të njejtin emër siç amendohet kohë pas kohe nga ONE Albania dhe publikohet në faqen e tij web.
Pajisje	Do të thotë njësitë e ndryshme të pajisjeve të telekomunikacioneve të cilat ONE Albania lejon që përdoruesi i Aksesit t'i instalojë.
Kamat Vonesa	0.5 % për çdo ditë vonese të pagesës përtej afatit të përcaktuar në faturë, por jo më shumë se 100% e vlerës së detyrimit të papaguar.
Pala dhënëse e informacionit	Pala e cila jep informacion për qëllimet e Nenit 11 të kësaj marrëveshje.
Mosmarrëveshje	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve sa i takon interpretimit apo zgjidhjes të cilitdo përcaktim të kësaj marrëveshje të paraqitur dhe zgjidhur në përputhje me Nenin 12 të kësaj Marrëveshje (duke përjashtuar shkeljet materiale të kësaj marreveshjeje).
Data e Pagesës (Due date)	Një datë, e cila është 30 ditë kalendarike pas datës së faturës me përjashtim të rastit kur është përcaktuar ndryshe.
Centralet telefonike të ONE Albania	Do të thotë ndërtesa e centralit telefonik, i vendosur në një ambient/Site, dhe që i përket ONE Albania dhe që do të specifikohet në secilën Marrëveshje Aksesit.
Rrjeti ONE Albania	Rrjeti i Telekomunikacioneve i cili zotërohet, operohet dhe mirëmbahet nga ONE Albania në përputhje me legjislacionin dhe autorizimet përkatëse në favor të tij.
Rjeti i Aksesit i ONE Albania	Pjesa e rrjetit ONE Albania e cila konsiston vetëm nga kanalet, tubacionet, dhomat, kutitë bashkuese, pusetat, shtyllat dhe punime të ngjashme deri në pika ndërfaqeje të tilla të cilat specifikohen kohë pas kohe nga ONE Albania (dhe që specifikisht përjashtojnë të gjitha aspektet e tjera të Rrjetit ONE Albania përfshirë por pa u kufizuar në, pajisjet transmetuese, pajisjet komutuese dhe burime të tjera të cilat mundësojnë përcjelljen e sinjaleve midis pikave terminale të përcaktuara, nëpërmjet televe, valëve, mjeteve optike apo mjeteve të tjera elektromagnetike, apo fasiliteve të tjera të rrjetit të telekomunikacioneve pa tela dhe të gjitha shërbimet e telekomunikacioneve.

Lista e tarifave të RUO të ONE Albania	Lista e tarifave të RUO të ONE Albania paraqet tarifat dhe/ose parimet e tarifimit për shërbimet e ofruara si pjese e RUO (Ofertës referencë të Aksesit) të ONE Albania.
Stafi i ONE Albania	Do të thotë cilido punonjës, agjent apo kontraktor i ONE Albania
Fasilitetet Ekzistuese të Centraleve	Hapësira ekzistuese e transmetimit dhe komutimit brenda një Centrali telefonik të ONE Albania
Operator i Autorizuar	Një person apo kompani i cili zotëron një autorizim të përshtatshëm nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare i Republikës së Shqipërisë
Aksesi i përbashket në rrjetin lokal Përbashket (Line Sharing)	Do të thotë një metodologji sipas të cilës shërbimi i frekuencave zanore që ofrohet nga ONE Albania dhe shërbimi i frekuencave të larta që ofrohet nga kerkuesi i aksesit mund të integrohen në të njëjtën linjë dypërcjellëse të bakrit siç përshkruhet në Aneks C, Skeda e Shërbimit 103.
Manuali i proceseve ndërmjet operatorëve	Do të thotë manuali me të njëjtin emër siç amendohet kohë pas kohe nga ONE Albania dhe publikohet ne faqen web te tij, bashkëngjitur këtij dokumenti.
Pronësia Intelektuale	Çdo patent, e drejte kopjimi, project, emer tregtar, markë, markë shërbimi apo tjetër pronësi intelektuale (e regjistruar apo jo) përfshirë por pa u kufizuar në, idetë, konceptet, njohuritë, teknikat, dezinjimet, specifikimet, skicimet, projektet, gjurmimet, diagramat, modelet dhe informacione të tjera të lidhura me cilëndo pronësi intelektuale te tillë.
AKEP	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
Rrjet	Rrjeti i ONE Albania apo rrjeti i kërkuarit të aksesit sipas rastit
Qendra e menaxhimit te rrjetit	a) Në rastin e ONE Albania b) Kërkuari i Aksesit
Palë	Cilado palë e kësaj marrveshjeje
Shërbimi i bashkëvendosjes fizike	Shërbimi i Aksesit i përshkruar në Aneksin C, Skeda e shërbimit 101 të kësaj marrveshjeje
Përshkrimi i Produktit	Përshkrimi i shërbimit të skeduar që ofrohet nga ONE Albania palës kërkuare
Data Gati për Shërbim (Ready for service date)	Data në të cilën një shërbim aksesi i porositur apo një veprimtari tjetër e kërkuar nga njëra palë tjetër, është kërkuar të jetë i disponueshëm (efektiv).
Pala Marrëse	Pala e cila merr çfarëdo informacioni nga pala tjetër lidhur me shërbimin e aksesit
Pala e Kërkuar	Pala të cilës i është kërkuar nga pala tjetër të kryejë një veprimtari lidhur me shërbimin e aksesit
Pala Kërkuare	Pala e cila kërkon palës tjetër të kryejë një veprimtari lidhur me shërbimet e aksesit

Shërbimet e Skeduara	Skedat të cilat bashkëlidhen në Aneksin C të kësaj Oferte Referencë të Aksesit, të cilat përshkruajnë shërbimet e Aksesit, dhe bazat mbi të cilat ato ofrohen.
Gjurma e Centralit të Shërbyer (Serviced Exchange Footprint)	Një hapësirë 400mm e thellë, x 600mm e gjërë x 2200 mm e lartë brenda një fasiliteti ekzistues centrali të ONE Albania për tu përdorur nga kërkuesi i Aksesit sipas Skedes së Shërbimit 101.
Oferta e Vendit	Do të thotë një ofertë e cila bëhet nga ONE Albania për kërkuenin e aksesit lidhur me bërjen të disponueshëm për kërkuenin e aksesit të shërbimeve të aksesit në atë Vend. Termat dhe kushtet e kësaj oferte të Vendit, përfshirë tarifat mund të ndryshojnë nëse kërkuesi i aksesit siguron informacin të cilin më parë kërkuesi i aksesit duhej të siguronte, ndryshon apo plotëson informacionin që ka siguruar më parë, ose nëse kërkuesi i aksesit bën një kërkesë për të ndryshuar ndonjë specifikim. Çdo kërkesë e tillë për të modifikuar Oferten e Vendit është subjekt i dakortësisë së ONE Albania.
Punimet për Pergatitjen e Vendit	Do të thotë punimet të cilat përcaktohen në Marrëveshjen e aksesit midis paleve për të mundësuar kërkesën e Kerkuesit të Aksesit për bashkëvendosjen fizike.
Vendi	Do të thotë një vendndodhje lidhur me të cilën është kryer një Këqyrje Vendi dhe për të cilën ONE Albania ka lëshuar një Ofertë Vendi për Kërkuenin e Aksesit lidhur me Shërbimet e Aksesit.
Manuali Teknik	Do të thotë dokumentacioni teknik që disponohet nga ONE Albania.
Palë e tretë	Cilado palë e cila nuk është palë e kësaj marrëveshjeje.
Operator palë e tretë	Cilido operator i cili nuk është palë e kësaj marrëveshjeje
Linjë e bakrit për përdorim të përbashkët (ULMP Aksesi i plotë në rrjetin local)	Një lidhje e linjës metalike dypërcjellëshe midis bllokut të kërkuetit të Aksesit në përmutator dhe njësisë terminale të rrjetit (NTU), ose një pikë terminale e rrjetit ku nuk ekziston një NTU, në premisat e pajtimtarit.
Shërbimet e linjës së bakrit për përdorim të përbashkët	Shërbimet e Aksesit të përshkruara në Aneksin C, Skeda e Shërbimit 102, Shtojca 1 e kësaj Marrëveshjeje.

ANEKS B
FATURIMI DHE PAGESAT

1. Përfituesi i aksesit do të jetë përgjegjës ndaj ONE Albania për pagesat e përcaktuara në Listën e çmimeve të RUO të ONE Albania (“Pagesat”) të kësaj Marrëveshjeje dhe në Marrëveshjen e Aksesit për çdo vënd.
2. Me dhënien e Ofertës për vëndin, ONE Albania i jepet e drejta të lëshojë një faturë në lidhje me detyrimin e pagesave dhe përfituesi i aksesit do të jetë përgjegjës për t’i paguar ONE Albania shumën e plotë të pagesave të shoqëruar me përgatitjet e Ofertës për vëndin përfshirë por pa u limituar në Shqyrtimin e Vëndit dhe pagesën për Ofertën e Vëndit ashtu siç përcaktohet më në detaje në Listën e Çmimeve të RUO të ONE Albania.
3. Me zbatimin e Marrëveshjes së Aksesit, ONE Albania i lind e drejta të paguhet për pagesën për përgatitjen e vendit përcaktuar në Skedarin 3 të Marrëveshjes së Aksesit. Përfituesit të aksesit do t’i kërkohet të paguajë pjesën e kërkuar të pagesës për përgatitjen e vendit jo më vonë se 30 ditë nga data e faturës, megjithatë në mënyrë që të rritet mundësia e ONE Albania për tu marrë me proceset e përgatitjes së vendit, përfituesi i aksesit mund ta bëjë pagesën më shpejt.
4. Çdo tarifë apo pagesë e aplikueshme sipas Marrëveshjes së Aksesit do të jetë e pagueshme në përputhje me parashikimet e kësaj Marrëveshjeje Aksesit.
5. Përfituesi i aksesit do të paguajë tatimin me vlerë të shtuar TVSH e aplikueshme mbi çdo pagesë që rrjedh në përputhje me termat e kësaj RO dhe Marrëveshjeje Aksesit.
6. Përveçse kur është shprehur ndryshe në këtë Marrëveshje, ONE Albania do të lëshojë fatura mujore për pagesat e shoqëruara me shërbimet e aksesit. Përveçse kur është shprehur ndryshe në këtë marrëveshje faturat lëshohen dhe janë të pagueshme në Lek. Faturat paguhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data e lëshimit të faturës, për sa kohë nuk është shprehur ndryshe në këtë Marrëveshjeje.
7. ONE Albania do të vërë në dispozicion informacion faturues në lidhje me çdo faturë.
8. Çdo mosmarrëveshje që rrjedh në lidhje me parimet (mënyrat) e pagesave të kësaj marrëveshjeje apo faturave në lidhje me pagesat, do të jetë subjekt i parashikimeve të nenit 12 të kësaj marrëveshjeje.

ANEKS C
INDEKSI I SKEDARËVE TË SHËRBIMEVE

- 101 BASHKËVENDOSJA FIZIKE
- 102 AKSESI I PLOTË NË RRJETIN LOKAL LLU (Full Unbundled Access LLU) (kur pika e aksesit është brenda ambienteve ONE Albania, ish centralet telefonike të ONE Albania)
- 103 AKSESI I PËRBASHKËT NË RRJETIN LOKAL ((Shared Access LLU) (kur pika e aksesit është brenda ambienteve ONE Albania, ish centralet telefonike të ONE Albania)
- 104 AKSES I PLOTË DHE AKSES I PERBASHKET NË RRJETIN LOKAL (LLU) - MSAN-et

ANEKS C
SKEDA E SHERBIMIT 101
BASHKËVENDOSJA

Kjo skedë shërbimi është efektive nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje dhe do të mbetet në fuqi deri në amendimin e saj ose si rrjedhim i një vendimi nga AKEP.

1. PERKUFIZIME

- 1.1. Në këtë Aneks, referenca për një dispozitë ose Shtojcë përveç rastit kur është shprehur ndryshe, është dispozitë apo Shtojcë e këtij Aneksi. Fjalët dhe shprehjet kanë kuptimin e dhënë në Aneks A.
- 1.2. Për qëllimin e këtij produkti, bashkëvendosje fizike është e disponueshme në fasilitetet ekzistuese të Centralit. Ky përkufizim nuk përjashton zgjerimin e ardhshëm të fasiliteteve të Centralit.

2. Përshkrimi i Shërbimit

- 2.1. Përshkrimi i produktit është dhënë në Shtojcën 1

Ofrimi i bashkëvendosjes fizike nga ONE Albania do të kryhet në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

- a) Manual i Proçeseve për bashkëvendosjen fizike në ONE Albania (bashkëngjitur këtij dokumenti;
- b) Marrëveshja e Nivelit të Shërbimit (SLA për bashkëvendosjen fizike)

3. Termat dhe Kushtet

- 3.1. Bashkëvendosje fizike do të ofrohet nga ONE Albania sipas kushteve të mëposhtme:

- 3.1.1. Bashkëvendosje fizike do t'i ofrohet kërkuarit të aksesit në përputhje me dispozitat urdhëruese të përshtatshme për bashkëvendosjen fizike të specifikuar në Manualin e proçeseve ndërmjet operatorëve për Bashkëvendosjen fizike (këtu e më poshtë Manuali i Proçeseve për bashkëvendosjen fizike)
- 3.1.2. Bashkëvendosja do t'i ofrohet kërkuarit të aksesit vetëm me depozitimin në ONE Albania të Formularit të Porosisë për Bashkëvendosjen fizike siç përcaktohet në Manualin e proçeseve për bashkëvendosjen fizike.
- 3.1.3. Çdo formular porosie i depozituar nga kërkuari i aksesit për bashkëvendosjen fizike do të referohet një centrali të veçantë të ONE Albania.
- 3.1.4. ONE Albania do të mbajë, një listë me pajisje (këtu e më poshtë i njohur si Regjistri i pajisjeve të bashkëvendosura), të cilat mund të bashkëvendosen dhe ku kërkuari i aksesit mund të përfshijë pajisjet e tij. ONE Albania ose çdo kërkuar tjetër aksesit mund të kundërshtojë përfshirjen e ndonjë pajisjeje në këtë listë dhe ky kundërshtim do të shikohet nëse zgjidhet në nivel industri fillimisht dhe nëse nuk zgjidhet do t'i referohet AKEP për zgjidhje.
 - 3.1.4.1. Kërkuari i aksesit do të bashkëvendosë fizikisht vetëm pajisje dhe pajisje shoqëruese "backhaul" të listuara në Regjistrin e bashkëvendosjes siç është përshkruar në Manualin e Proçeseve për bashkëvendosjen fizike.
 - 3.1.4.2. Nëse një pajisje e vecantë është bashkëngjitur listës, kërkuari i aksesit do të jetë i lirë ta vendosë në hapësirat për bashkëvendosje pa nevojën për aprovime të mëtejshme nga ONE Albania. Megjithatë,

ONE Albania do të kërkojë informacion që do të mundësohet përpara instalimit të pajisjes, me qëllim mbrojtjen e shëndetit, sigurisë dhe mirëmbajtjen e integritetit të rrjetit.

- 3.1.5. Kërkuesi i aksesit do të jetë përgjegjës për instalimin, operimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të tij brenda gjurmës së tij të ofruar.
- 3.1.6. Bashkëvendosja fizike do të jetë brenda faciliteteve ekzistuese të centralit, ONE Albania nuk do të ndërtojë apo të ndryshojë strukturalisht ndonjë facilitet të ri të centralit apo të ofrojë hapësira në ambjentet e ONE Albania për strukturat e kërkuesit të aksesit. Megjithatë, zhvillimet e ardhshme të faciliteteve të centraleve brenda ONE Albania do të informohen nëpërmjet porositjeve paraprake të marra në përputhje me Manualin e Proçeseve midis operatorëve dhe gjithashtu mund të ndodhë në vijim të konsultimit rast pas rasti për kërkesa individuale për zonë (hapësirë). Përcaktimi i hapësirës në facilitetet e centralit të ONE Albania do të jetë në përputhje me Planet ekzistuese të rrjetit të ONE Albania.
- 3.1.7. Gjurma e centralit të shërbyer do t'i caktohet sipas parimit, atij që vjen i pari shërbehet i pari (Proçesi i perzgjedhjes përshkruhet në Manualin e Proçeseve për bashkëvendosjen fizike).
- 3.1.8. Nëse shërbimi nuk mund të ofrohet mbi baza të plotësueshmerise apo nevojës për mirëmbajtjen e integritetit të rrjetit apo mungesës së kapacitetit për shkak të mosdisponueshmerisë apo papërshtatshmërisë së një hapësirë të dyshemesë së centralit, produkti nuk do të ofrohet. Çdo refuzim i tillë do të shoqërohet nga një arsyetim dhe mundet që me kërkesën e përfituesit të mundshëm t'i vihet në dispozicion edhe Autoritetit Rregullator Kombëtar (AKEP).
- 3.1.9. Kushtet për kërkuesin e aksesit për të inspektuar vendet në të cilat bashkëvendosja fizike është e disponueshme, apo vendet ku bashkëvendosja është refuzuar për shkaqe të mungesës së kapacitetit janë të specifikuar në Manualin e Proçeseve për bashkëvendosjen fizike.
- 3.1.10. Çdo kërkues aksesi që ndan çdo gjurmë centrali të shërbyer të tillë do të kërkohet të zbatojë rregullat në varësi të pjesës së gjurmës së centralit të shërbyer që do të zihet nga një kërkues aksesi i vencantë.
- 3.1.11. Ofrimi i bashkëvendosjes fizike nga ONE Albania është subjekt i SLA për bashkëvendosjen fizike.
- 3.1.12. I gjithë stafi i kërkuesit të aksesit, përpara se të lejohen të hyjnë në ndonjë ambjent të ONE Albania me qëllimin e ofrimit të shërbimeve të aksesit do t'u kërkohet të regjistrohen në përputhje me parashikimet e Marrëveshjes së Aksesit.
- 3.1.13. Kërkuesi i aksesit do të veprojë në përputhje dhe do të sigurojë që i gjithë stafi i tij do të veprojë në përputhje me të gjitha kërkesat on-site të sigurisë siç kërkohet në mënyrë të arsyeshme nga menaxherët e centraleve të ONE Albania dhe specifikuar në Proçedurat e Sigurisë dhe Aksesit të ONE Albania bashkëngjitur si Shtojca 3.
- 3.1.14. Kërkuesi i aksesit do të veprojë në përputhje dhe do të sigurojë që i gjithë stafi i tij do të veprojë

në përputhje me të gjitha rregulloret për sigurinë dhe shëndetin siç do të kërkohet në mënyrë të arsyeshme nga menaxherët e centraleve të ONE Albania.

3.1.14.1. Dështimi nga stafi i kërkuesit të aksesit për të vepruar në përputhje me të gjitha rregulloret për sigurinë dhe shëndetin e përcaktuar nga ONE Albania si dhe specifikuar në procedurat e shëndetit dhe sigurisë së ONE Albania siç është përcaktuar dhe në Manualin e proceseve për bashkëvendosjen fizike do të jetë subjekt i Marrëveshjes së Aksesit .

3.1.15. Të gjitha hyrjet në ambjentet e centraleve të ONE Albania do të jenë hyrje të shoqëruara dhe në përputhje me termat e Marrëveshjes së Aksesit.

3.1.16. ONE Albania do të ofrojë shërbimin e bashkëvendosjes fizike në përputhje me termat e Marrëveshjes së Aksesit.

4. Koha e Lëvrimit

4.1.1.Koha e lëvrimit do të jetë sic parashikohet në Manualin e Proceseve dhe do të jetë subjekt i SLA për bashkëvendosjen fizike.

5. Struktura e pagesave

Cmimet e listuara në Listën e Çmimeve të RUO të ONE Albania aplikohen vetëm për produktin e LLU njohur si “bashkëvendosja fizike”, siç përshkruhet në Aneks C, skeda e shërbimit 101 e Ofertës Referencë të Aksesit dhe jo ndonjë produkti tjetër që ka lidhje me bashkëvendosjen. Çmimet e përcaktuara në Listën e çmimeve të RUO të ONE Albania janë gjithashtu të aplikueshme vetëm kur shpenzimet kapitale të kërkuara për përgatitjen e vendit të centralit janë relativisht të ulta. Kështu që është e përshtatshme që, kur shpenzimi kapital aktual tejkalon çmimin e kontributit për kapitalin upfront prodhuar nga parimet (mënyrat) e pagesave për çdo central me më shumë se 2.000 Euro, ONE Albania do të lejohet të rikuperojë koston aktuale të përgatitjes së vëndit.

Nuk është qëllim që çmimet për bashkëvendosjen apo inputet të aplikohen në rrethana jashtë skedës së shërbimit 101, psh kur ONE Albania kërkohet që të shndërrojë strukturalisht apo të ndërtojë një facilitet të ri centrali apo të ofrojë hapësirë në ambjentet e ONE Albania për strukturat e kërkuesit të aksesit. Në rrethanat që kërkesa e kërkuesit të aksesit do të kërkonte që ONE Albania strukturalisht të shndërrojë apo ndërtojë një facilitet të ri centrali apo ti ofrojë hapësirë në ambjentet e ONE Albania për strukturat e kërkuesit të aksesit, kostoja e këtyre punimeve do të rikuperohet nga kërkuesi i aksesit si një pagesë fillestare.

LLOJET DHE ALOKIMI I BASHKVENDOSJES

1. ONE Albania ofron në centralet lokale të ONE Albania një nga format e mëposhtme të bashkëvendosjes:

- a) bashkëvendosje fizike;
- b) bashkëvendosje në distancë;
- c) bashkëvendosje virtuale

ONE Albania ofron të pakten një nga format e mësipërme të bashkëvendosjes.

2. ONE Albania alokon hapësirën e bashkëvendosjes fizike në të njejtat ambiente të tij ku ndodhet i instaluar elementi i rrjetit tek i cili sigurohet aksesit sipas prioritetit në vijim:
 - a) Pa instalime të ndarjeve apo të strukturave të tjera mbrojtëse;
 - b) Me instalime të një ndarje apo një tjetër strukturë mbrojtëse, e cila kryhet nga ONE Albania në emër të operatorit përfitues dhe kundrejt një pagese.

3. ONE Albania alokon hapësirën e bashkëvendosjes në distancë në ambientet e tij sipas prioritetit në vijim:
 - a) Në një dhomë të veçantë, të ndryshme nga ajo në të cilën është instaluar permutatori kryesor apo i ndërmjetëm, ose;
 - b) Në dhoma të pa-pajisura të ONE Albania, instalimi kryhet nga ONE Albania me pagesë nga operatori përfitues, apo nga vetë operatori përfitues me shpenzimet e tij për të pajisur apo përshtatur këto dhoma. Kur ONE Albania refuzon të kryejë punët e sipërpërmendura, ai lejon operatorin përfitues t'i kryejë ato.

4. Kur operatori përfitues pajis një hapësirë të bashkëvendosjes në ambientet e tij, ONE Albania:
 - a) Ofron një kabëll lidhës të jashtëm. Në rastin kur operatori përfitues vendos ta blejë shërbimin prej një operatori tjetër apo ta vendosë kabllin vetë, ONE Albania e informon operatorin përfitues për mundësinë e përdorimit të tubacioneve të tij apo fasiliteve të tjera shoqëruese, ose;
 - b) Ofron një mundësi për të instaluar një sistem antenë për lidhjen e pikës së aksesit me rrjetin, i cili vihet në punë nga operatori përfitues përmes radiokomunikimit.

5. Në rast se bashkëvendosja në pikën e aksesit, e zgjedhur nga operatori përfitues, instalohet në mënyrat e përmendura në pikën 2.b apo 3.b të këtij neni, ONE Albania:
 - a) Brenda 15 ditëve nga data e marrjes së kërkesës, në rastet e përmendura në pikën 2.b apo 3.b të këtij neni përgatit dhe i paraqet operatorit përfitues vlerësimin e kostove të punimeve (preventivin), të nevojshme për instalimin e bashkëvendosjes;
 - b) Brenda një afati 36 ditor, në rastin e përmendur në paragrafin 2.b të këtij neni ose brenda një afati 60 ditor në rastin e përmendur në pikën 3.b të këtij neni që prej momentit të marrjes së miratimit prej operatorit përfitues për vlerësimin e kostove të punimeve, ONE Albania e pajis plotësisht hapësirën e bashkëvendosjes.

6. ONE Albania ofron bashkëvendosje virtuale në rast se ai nuk ka mundësi teknike për të alokuar bashkëvendosjen fizike për të cilën operatori përfitues ka paraqitur një kërkesë. Në rastin e bashkëvendosjes virtuale, stafi i ONE Albania do të ekzekutojë instalimin dhe mbikqyrjen e të gjitha pajisjeve të operatorit përfitues.


7. Format e mësipërme të bashkëvendosjes ofrohen për linjat e bakrit të pajtimtarëve të lidhur me MDF ose RSU.

Aksesi për LLU në MSAN

ONE Albania ka përfunduar procesin e migrimit të rrjetit në NGN/NGA duke implementuar FttC (Fiber to the Curb/Cabinet), ku rrjeti i aksesit është me fibra optike deri në kabinetet e rrugës (MSAN) dhe më

pas me linjë bakri.

Skeme e thjeshtezuar e FttC



Note*: DSLAM or MSAN.

Për këto linja bakri të lidhura me MSAN, pika e aksesit në rrjetin e ONE Albania për shërbimet e LLU do të jetë në kabinetet e MSAN dhe bashkëvendosja ofrohet:

- brenda në kabinetin MSAN ku janë pajisjet e ONE Albania, nëse ka hapësirë, duke aplikuar parimin kush vjen i pari shërbehet i pari;

Në rast se bashkëvendosja brenda në kabinet nuk është e mundur, operatori përfitues, nëse është i interesuar, mund të ndërtojë vetë një kabinet në afërsi (paralel ose mbi) kabinetin e ONE Albania, pa penguar aksesin dhe funksionimin e kabinetit të ONE Albania. Operatori përfitues është përgjegjës për sigurimin e lejeve përkatëse nga organet kompetente për instalimin e kabinetit të tij pranë kabinetit të ONE Albania.

Për këto raste ONE Albania ofron lidhjen me kabllot të jashtëm të kabinetit të tij me kabinetin e Operatorit përfitues, kundrejt pagesave ose lejon operatorin përfitues të ofrojë kabllot e jashtëm.

Tarifat e aplikuarat të LLU-së në këtë rast janë për aksesin e plote dhe aksesin e përbashkët në rrjetin lokal MSAN-e.

Akses në elemente pasive të rrjetit për të arritur pikat e aksesit në MSAN

Nëse operatori përfitues është i interesuar për akses në kanalet/tubacionet/dark fiber në mënyrë që të arrijë pikat e aksesit në MSAN-et e ONE Albania, operatori përfitues duhet të bëjë një kërkesë për produkt të tillë. Kërkesa duhet të jetë specifike dhe duhet të përmbajë informacion për dy pikat e lidhjes: pikën ku do lidhet me ONE Albania dhe MSAN/MSAN-et që kërkon të arrijë. Me marrjen e kërkesës ONE Albania do të vlerësojë mundësitë teknike dhe do të japë përgjigje operatorit përfitues, brenda 30 ditëve, në lidhje me:

- Mundësinë teknike të realizimit, dhe nëse është e mundur;
- Pagesat përkatëse për ofrimin e shërbimit/produktit dhe afatet e realizimit.

SHTOJCA 1
I SKEDËS SË SHËRBIMIT 101
PËRSHKRIMI I PRODUKTIT TË BASHKËVENDOSJES FIZIKE

Përmbajtja:

1. Hyrje

2. Përshkrimi i shërbimit

2.1. Elementët e produktit

- 2.1.1. Aksesit në rrjetin e kërkuesit të aksesit
- 2.1.2. Dhoma e MDF
- 2.1.3. Rrugët e kalimit (runëays) të dyshemesë teknologjike të centralit
- 2.1.4. Pajisjet e gjurmës
- 2.1.5. Korridor i hapësirës
- 2.1.6. Energjia DC
- 2.1.7. Energjia AC
- 2.1.8. Ndricimi
- 2.1.9. Sistemimi i Rack-ut
- 2.1.10. Instalimi i pajisjeve të kërkuesit të aksesit dhe kabllot shoqëruese
- 2.1.11. Fasilitetet ndihmëse
- 2.1.12. Ajri i kondicionuar
- 2.1.13. Siguria
- 2.1.14. Shëndeti dhe siguria
- 2.1.15. Togëzimi
- 2.1.16. Ngarkimi i dyshemesë
- 2.1.17. Kushtet e ambjentit
- 2.1.18. Shërbimi telefonik
- 2.1.19. Sistemet e detektimit të zjarrit dhe tymit
- 2.1.20. Shpërndarja e nxehtësisë

3. Disponueshmëria e produktit

4. Përgjegjësitë për shërbimin

5. Menaxhimi i shërbimit

- 5.1. Porosia
- 5.2. Lëvrimi i shërbimit
- 5.3. Operimi dhe mirëmbajtja e rrjetit
- 5.4. Riparimi i difekteve
- 5.5. Nivelet e shërbimit

1. Hyrje

- 1.1. Ky dokument përcakton përshkrimin e produktit të rënë dakort në nivel industrie për të mbështetur bashkëvendosjen fizike.
- 1.2. Proçesi dhe detajet teknike që mbështesin implementimin e shërbimit janë të specifikuar në Manualin e Proçeseve ndërmjet operatorëve për bashkëvendosjen fizike.
- 1.3. Të gjitha pajisjet dhe impiantet të vendosura si pjesë e implementimit të shërbimit do të jenë në përputhje me standartet përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare, ashtu sic do të jetë e përshtatshme. Të gjitha procedurat e instalimit duhet të jenë konform praktikës standarte të industrisë.
- 1.4. Elementët e ndryshëm të produktit dhe lidhjet mes tyre janë diagramatiksht të dhëna në Manualin e Proçeseve për bashkëvendosjen fizike.

2. Përshkrimi i produktit

Për bashkëvendosjen fizike, ONE Albania do të mundësojë një gjurmë të centralit të shërbyer kur është e përshtatshme.

Gjurmët e centralit do të ofrohen në ambiente të vecanta të bashkëvendosjes në preferencë me ambientet mikse (të përziera) kur është e mundshme.

Kërkuesi i aksesit do të zgjedhë pajisjen, furnizimin me energji, instalimin, do ta operojë dhe mirëmbajë atë nëpërmjet dhomës së MDF-së së ONE Albania dhe kablllove lidhës të kërkuesit të aksesit.

Kërkuesi i aksesit do të lidhë pajisjet e tij, të instaluar në gjurmët e centralit të shërbyer të ONE Albania tek ODF e kërkuesit të aksesit që gjendet gjithashtu brënda gjurmës së centralit të shërbyer brenda ambienteve të ONE Albania. Detajet dhe metoda e lidhjes do të përcaktohet në Manualin e Proçeseve për bashkëvendosjen fizike.

2.1. Elementët e produktit

2.1.1. Aksesi në rrjetin e kërkuesit të aksesit.

- 2.1.1.1. Në mënyrë që të sigurohet që pajisja e kërkuesit të aksesit, e ndodhur në gjurmën e centralit të shërbyer të ONE Albania, mund të lidhet me rrjetin e kërkuesit të aksesit, propozohet si më poshtë:
 - 2.1.1.1.1 ONE Albania do të caktojë dhe të bjerë dakort për një pusëtë me kërkuesin e aksesit pranë centralit të ONE Albania dhe aty ku është e mundur ONE Albania do të caktojë dhe të bjerë dakort për dy puseta në secilin anë të centralit për të mbështetur aksesin e kërkuesit të aksesit. Pusetat e rena dakort do të jenë aty ku është e mundshme dhe e zakonshme për ato që janë caktuar për ofrimin e shërbimit të interkoneksionit të ndërmjetëm.
 - 2.1.1.1.2 Kërkuesi i aksesit do të ndërtojë apo do bjerë dakort të përdorë një pusëtë ekzistuese të ndërtuar nga kërkuesi i aksesit brënda një distance të arsyeshme nga puseta e rënë dakort me ONE Albania. Kërkuesi i aksesit do të ndërtojë një tubacion mes dy pusetave dhe ONE Albania do të mundësojë një pikë hyrjeje për tubacionin e kërkuesit të aksesit për në pusëtën e ONE Albania. ONE Albania do të përshkojë fibrën optike të kërkuesit të aksesit nga puseta e kërkuesit të aksesit dhe puseta e ONE Albania për në ODF e kërkuesit të aksesit në centralin e ONE Albania.
 - 2.1.1.1.3 Kërkuesi i aksesit do të jetë plotësisht përgjegjës për lejet dhe autorizimet nga organet e qeverisjes

vendore për ndërtimin e pusetave dhe tubacioneve dhe do të informojë paraprakisht edhe ONE Albania në lidhje me këto leje dhe/apo autorizime.

2.1.1.1.4 Kërkuesi i aksesit do të mundësojë më pas dhe instalojë kabllin e fibrës optike nga puseta e ndërtuar e kërkuesit të aksesit, duke përdorur tubacionet e tyre në drejtim të rrjetit të tyre.

2.1.2. Dhoma e MDF

2.1.2.1. Pajisja e kërkuesit të aksesit do të jetë e lidhur tek linja e bakrit dypërcjellëse e pajtimtarit nëpërmjet MDF së ONE Albania në mënyrë që të përdorë produktet e tjera të ONE Albania, psh, aksesin e plotë në linjën e bakrit (full access) apo aksesin e përbashket në linjën e bakrit (shared access). Çdo kërkesë e specifikuar në përshkrimin e produktit respektiv do të aplikohet gjithashtu.

2.1.3. Rrugët e kalimit të kabllave të dyshemesë së centralit

2.1.3.1. Në marrëveshje me ONE Albania, kërkuesi i aksesit do të përdorë shtratet (trays) ekzistuese të kabllave, ku është e mundur, mbi apo nën dysheme, të cilat do të vecohen (izolohen) nga kabllot e telekomit, të sinjalizimit apo të energjisë elektrike.

2.1.3.2. Nëse rrugët e kalimit të kabllave nuk janë të disponueshme, do të dizajnohen dhe mundësohen shtrate (tray) të tjera kabllorë me pagesën e përgatitjes së vëndit. Të gjitha procedurat e instalimit do të jenë konform praktikës më të mirë të industrisë.

2.1.4. Gjurma e pajisjes

2.1.4.1. Standarti i Gjurmës është 400mm thellësi, 600mm gjërësi dhe 2.2m e lartë. Gjurmët dyshe do të lejohen në instalime shpinë më shpinë me 800mm thellësi, 600mm gjërësi dhe 2.2m lartësi.

2.1.5. Korridori i hapësirës (aisle space)

2.1.5.1. Kërkesat për distancën janë si më poshtë:

2.1.5.1.1 Rack-et që qëndrojnë të vetëm do të pozicionohen minimalisht 1 metër nga çdo mur.

2.1.5.1.2 Distanca midis ambjenteve (suites) duhet të jetë minimalisht 900 mm.

2.1.6. Energjia D.C

2.1.6.1. Çdo kërkues aksesi do të ofrohet me akses në një pikë shpërndarjeje me ushqim dy drejtimësh minus 48 vold DC. Secila do të ketë aftësinë për të mundësuar 60 amps në total. Çdo (pint) shpërndarjeje do të përbëjë një shtresë në një rack shpërndarës. ONE Albania do të furnizojë, instalojë dhe do të vërë në punë çdo pikë shpërndarjeje subjekt i gjithë informacionit të kërkuar në formën e duhur ofruar nga kërkuesi i aksesit, përfshirë parametrat (kapaciteti dhe lloji) e siguresës (circuit breakers) të kërkuar, kur do duhet të ofrohen fasilite të reja. ONE Albania do të jetë përgjegjës për monitorimin dhe mirëmbajtjen e furnizimit me energji DC por pa përfshirë siguresën (circuit breaker) e kërkuesit të aksesit (mundësuar dhe instaluar nga ONE Albania) brënda pikës së shpërndarjes. Kërkuesi i aksesit do të jetë përgjegjës për mundësimin, instalimin dhe mirëmbajtjen e të gjithë energjisë dhe kabllit të togëzimit dhe pajisjeve shtesë, duke përjashtuar instalimin e shtarteve të kabllave (cable tray) – nga pika e shpërndarjes tek pajisja. Kjo energji DC nuk prezumon disponueshmërinë e energjisë AC nga kompania furnizuese. Ofrimi i energjisë DC është subjekt i

kushteve të vendit, e cila mund të ndryshojë. Shënim: pika e shpërndarjes i referohet “best fit” (përshtatshëm më të mirë) MCCB (miniature Current Circuit Breaker) ose pozicioni i siguresës (fuse) në vënd në diskrecion të ONE Albania.

2.1.6.2. Do mundësohet një çelës izolues në kabinën shpërndarëse të energjisë DC të kerkuesit të aksesit, e cila do të mundësojë izolimin elektrikisht të shpërndarjes në rastet e një emergjence apo aksidenti.

2.1.7. Energjia AC

2.1.7.1. Energjia ekzistuese AC do të jetë e disponueshme për përdorim brënda zonës së centralit vetëm për pajisjet test.

2.1.7.2. ONE Albania do të caktojë një prizë ekzistuese 13AMP për çdo ambjent për përdorim të kerkuesit të aksesit.

2.1.8. Ndriçimi

2.1.8.1. I gjithë ndriçimi do të përputhet me një minimum prej 500 lux kur matet në nivel pune.

2.1.9. Sistemimi i Rack-ut

2.1.9.1. Sistemimet e rack-ut duhet të përputhen me standartet ekzistuese brënda ndërtesës së centralit.

2.1.10. Instalimi i pajisjeve të kerkuesit të aksesit dhe kabllot shoqëruese

2.1.10.1. Pajisja do të jetë në përputhje me standartet dhe specifikimet e duhura përkatëse të ITU/ETSI dhe instalimi dhe mirëmbajtja në përputhje me praktikën më të mirë të industrisë.

2.1.11. Fasilitetet ndihmëse

2.1.11.1. Kerkuesi i aksesit do të lejohet të përdorë të gjitha fasilitetet ekzistuese të tualeteve.

2.1.12. Ajri i kondicionuar

2.1.12.1. Ajri i kondicionuar i përshtatshëm është zakonisht i mundur nga ONE Albania në cdo mjedis të madh centrali, megjithatë ofrimi i ajrit të kondicionuar për një kerkues të vecantë aksesit në cdo central do të varet nga detajet që jep kerkuesi i aksesit për parametrat e shpërndarjes së nxehtësisë së pajisjes, ndërkohë që mund të mundësohen edhe pajisje të tjera.

2.1.13. Siguria

2.1.13.1. Kerkuesi i aksesit do të veprojë në përputhje me të gjitha kërkesat e sigurisë në vend, siç kërkohet brënda arsyes nga menaxherët e centraleve të ONE Albania dhe specifikuar në Marrëveshjen e Aksesit të ONE Albania.

2.1.13.2. Aksesit është i shoqëruar

2.1.14. Shëndeti dhe siguria

2.1.14.1. Kerkuesi i aksesit do të jetë në përputhje me të gjitha aspektet e shëndetit dhe sigurisë siç drejtohet

nga oficerët e shëndetit dhe sigurisë së ONE Albania dhe kërkesave të përgjithshme për shëndetin dhe sigurinë e specifikuar në Marrëveshjen e Aksesit.

2.1.15. Togëzimi

- 2.1.15.1. Togëzimi i zakonshëm është i mundësuar në të gjitha ndërtesat e centraleve të ONE Albania për pajisjet e telekomunikacioneve. Do të jetë përgjegjësi e kërkuarit të aksesit që të sigurojë që të gjitha pajisjet e tyre të jenë të togëzuara brenda dyshemesë së centralit dhe në përputhje me praktikën brenda një centrali të vecantë.
- 2.1.15.2. Nëse është e nevojshme ndërmarrja e ndryshimeve në togëzimin e centralit për shkak të instalimit të pajisjes së kërkuarit të aksesit, kërkuarit të aksesit do t'i këshillohet që kabllo të shoqëruet dhe çdo rrugë kalimi tjetër i kabllove, të kryhet pas një shqyrtimi të centralit dhe kryesisht të ndërmerret nga ONE Albania.

2.1.16. Ngarkesa e dyshemesë

- 2.1.16.1. Kur mundësohen dysheme fallso, ato janë të afta të ngarkohen deri në 20 kn./m katro max
- 2.1.16.2. Përcaktimi i ngarkesës së dyshemesë do të jetë subjekt i kushteve të vëndit.

2.1.17. Kushtet e ambjentit

- 2.1.17.1. Temperatura e centraleve të ONE Albania mbahet normalisht mes 18 dhe 22 gradeve.
- 2.1.17.2. Alarmi i temperaturës në centralet e ONE Albania monitorohet nga qendra e menaxhimit të rrjetit (NMC).
- 2.1.17.3. Nivelet e lagështirës variojnë mes 20% dhe 80% dhe tharja ofrohet si pjesë e procesit të ftohjes. Lagështira nuk ofrohet për shkak të rrezikut të rrjedhjeve të ujit.

2.1.18. Shërbimi telefonik

- 2.1.18.1. ONE Albania do të ofrojë, me kërkesë, një linjë telefonike për komunikimin zanor si pjesë e këtij produkti, megjithatë, ofrimi i një telefoni dhe çdo shërbim telefonik kufizues do të jetë sipas ofertave të pakicës së ONE Albania. Proçedurat për porosinë janë sipas Manualit të Proçeseve ndërmjet operatorëve për bashkëvendosjen fizike.

2.1.19. Sistemet e detektimit të zjarrit dhe tymit

- 2.1.19.1. Sistemet e detektimit për zjarr dhe tym do të variojnë në varësi të përmasave të centraleve.
- 2.1.19.2. Centralet e mëdha kanë sisteme automatike të detektimit të zjarrit që mbulojnë zonën e dyshemesë së centralit.
- 2.1.19.3. Në centralet më të vogla, janë të disponueshme vetëm alarmet manuale të zjarrit, psh pikat e njoftimit manual.

2.1.20. Shpërndarja e nxehtësisë

- 2.1.20.1. Shpërndarja individuale e nxehtësisë për çdo gjurmë nuk duhet të kalojë 2kw. Shpërndarja e nxehtësisë në tejkalim të kësaj mund të ndikojë operimin e pajisjes tjetër të centralit dhe të zvogëlojë

efektin e sistemit të ajrit të kondicionuar.

- 2.1.20.2. Rack-et e paisjeve të kërkuesit të aksesit duhet të kenë freksueset e tyre për të lëshuar ajër të ftohtë kur shpërndarja e nxehtësisë kalon 1kw për gjurmë.
- 2.1.20.3. Bashkëvendosja fizike mund të refuzohet nëse shpërndarja e nxehtësisë për gjurmë konsiderohet e tepërt (psh më shumë se 2kw për gjurmë) nga ONE Albania duke sjellë potencialisht mundësinë për të ndikuar tek pajisjet e ONE Albania apo të kërkuesve të tjerë të aksesit.

3. Disponueshmëria e produktit

- 3.1.1.1. Nëse shërbimi nuk do mund të ofrohet mbi baza të fizibilitetit apo nevojës për të mirëmbajtur integritetin e rrjetit apo mungesës së kapacitetit për shkak të mosdipsonueshmërisë apo papërshtatshmërisë të hapësirës së dyshemesë së centralit, produkti nuk do të jetë i disponueshëm.
- 3.1.1.2. Në asnjë rast ky produkt nuk do të konsiderohet si i disponueshëm në të gjitha centralet e ONE Albania, pasi kjo do të jetë në varësi të karakteristikave individuale të centralit.
- 3.1.1.3. ONE Albania në faqen e internetit në seksionin e dedikuar LLU do të jap informacion për ambientet ku ofrohet bashkëvendosje fizike sipas përditësimit të Aneks F.

4. Përgjegjësitë e shërbimit

- 4.1. Përgjegjësitë e përshtatshme të secilës palë janë sipas nënvizimeve në Marrëveshjen specifike të Aksesit për vëndin.
- 4.2. Në cdo kohë ONE Albania do të jetë përgjegjës për ndërtesat e centraleve dhe stafin e ONE Albania që ndodhet brënda tyre.
- 4.3. Kërkuesi i aksesit do të specifikojë pajisjet përkatëse për t'u instaluar në përputhje me Manualin e Proceseve ndërmjet operatorëve.
- 4.4. Kërkuesi i aksesit do të jetë përgjegjës për identifikimin e ndonjë defekti që mund të ndodhë në pajisjet e tij apo shërbimin dhe të lokalizojë ndonjë defekt në rrjetin e ONE Albania në linjë me procesin e riparimit të defekteve sic është e nënvizuar në Manualin e Proceseve ndërmjet operatorëve.
- 4.5. Nëse kërkuesi i aksesit blen pajisje të cilat nuk mund të instalohen duke përdorur fasilitet e ofruara nga ONE Albania, përgjegjësia për blerjen është e kërkuesit të aksesit.

5. Menaxhimi i shërbimit

5.1. Porosia

- 5.1.1. Ndërfaqja midis kërkuesit të aksesit dhe ONE Albania për depozitimin e porosive është sipas Manualit të Proceseve për bashkëvendosjen fizike.

5.2. Ofrimi i shërbimit

- 5.2.1. Ofrimi i shërbimit dotë jetë sipas Manualit të Proceseve për bashkëvendosjen fizike.

5.3. Operimi dhe mirëmbajtja e rrjetit

- 5.3.1. Proçeset për operimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit do të jenë sipas Manualit të

Proçeseve për bashkëvendosjen fizike.

5.4. Riparimi i defekteve

5.4.1. Proçeset për riparimin e defekteve do të jetë sipas Manualit të Proçeseve për bashkëvendosjen fizike.

5.5. Nivelet e shërbimit

5.5.1. Nivelet specifike të shërbimit janë të nënvizuara në seksionin e niveleve të shërbimit në Aneks 1, Seksioni A i Marrëveshjes së aksesit.

SHTOJCA 2
E SKEDËS SË SHËRBIMIT 101
PROÇEDURAT E AKSESIT DHE SIGURISË PËR BASHKËVENDOSJEN FIZIKE

1. Parathënie

1.1. Ky dokument do të menaxhohet në përputhje me procedurat për kontrollin e ndryshimeve formale të Ofertës Referencë të Aksesit.

1.2. Përkufizime

Fjalët dhe shprehjet kanë kuptimin e dhënë në Aneks A, përveçse siç tregohet më poshtë:

Akses i pashoqëruar:	<i>Do të thotë autorizimi i një individi të regjistruar dhe akredituar dhe/ose kontraktori të regjistruar të një kërkuesi të aksesit për tu marrë me një ndryshim jo material dhe /ose të riparojë në emër të kërkuetit të aksesit në centralet ku kërkueti i aksesit ka marre bashkevendosje</i>
Periudha e provës	<i>Do të thotë vetëm në diskrecion të ONE Albania, një periudhë prej 12 muajsh që duhet të aplikohet nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes së Aksesit për një vënd nga kërkueti i aksesit.</i>

1.3. Hyrje

Ky dokument nënvizon procedurat për aksesin dhe sigurinë për kërkuetin e aksesit të cilët punojnë në centralet e ONE Albania si pjesë e shërbimit të aksesit të bashkëvendosjes fizike. Brenda rrjetit të ONE Albania, ka një numër të madh centralesh që janë centralet lokale, RSU-të e vogla dhe MSA-net. Këto janë të hostuara në një varietet ndërtesash nga ndërtesa shumëkatëshe të mëdha, ndërtesa në qendër të qytetit deri tek ndërtesa me një dhomë më të vogla se 20 m katror.

2. Procedurat

Aty ku ONE Albania ofron bashkëvendosje fizike për një kërkuet aksesi, do të aplikohen procedurat e akreditimit të kërkuetit të aksesit si më poshtë:

2.1. Kërkueti i aksesit, si parakusht për t'ju ofruar bashkëvendosja fizike në centralet e ONE Albania, do t'i nënshtrohet dhe do sigurojë akreditimin. Qëllimi i procesit të Akreditimit është që Kërkueti i Aksesit dhe stafi i tij të kuptojnë kërkesat e ONE Albania në lidhje me Sigurinë dhe Shëndetin në ambientet e ONE Albania. Akredimi do të bëhet në bazë kompanie (operatori). Persona individuale të stafit të kërkuetit të aksesit nuk do të akreditohen por do të regjistrohen sipas procesit të mëposhtëm.

2.1.1. Faza e Njoftimit:

2.1.1.1. Në mënyrë që një anëtar i stafit të Kërkuesit të aksesit të rregjistrohet për të aksesuar një ambient të ONE Albania, kërkuesi i aksesit duhet ti dërgojë ONE Albania informacionin e mëposhtem për këtë person”:

- Emri/Mbiemri
- Kopje të mjetit të identifikimit (ID)
- Adresa e punës dhe numri i telefonit për tu kontaktuar

2.1.1.2. ONE Albania bën konfirminin e marrjes së informacionit nëpërmjet një emaili dërguar pikës së kontaktit të kërkuesit të aksesit, brenda dy ditëve pune nga marrja e informacionit. Në rast se informacioni i dërguar është i plotë, ONE Albania bën rregjistrimin e anëtarit të stafit të kërkuesit të aksesit brenda 5 ditëve pune nga marrja e informacionit. Në rast se informacioni i dërguar nga kërkuesi i aksesit nuk është i plotë, ONE Albania refuzon regjistrimin duke njoftuar kërkuesin e aksesit brenda dy ditëve nga marrja e informacionit. Kërkuesi i aksesit duhet të ridërgoje informacionin e plotë.

2.1.2. Trajnimi

2.1.2.1. ONE Albania do t'i dërgojë kërkuesit të aksesit dokumentin “Kërkesat e ONE Albania për shëndetin dhe sigurinë për bashkëvendosjen e pajisjeve të kërkuesit të aksesit në centralet e ONE Albania” që përmban parimet kryesore dhe rregullat e ruajtjes së shëndetit dhe sigurisë dhe aksesit për tu ndjekur nga anëtarët e stafit të kërkuesit të aksesit të rregjistruar si më lart, gjatë vizitave të tyre në ambientet e ONE Albania.

2.1.2.2. Kërkuesi i aksesit do të vëzhgojë dhe do të sigurojë më tej që stafi i kërkuesit të aksesit dhe kontraktorët po ashtu do të përputhen më këto kërkesa.

2.1.2.3. Stafi i kërkuesit të aksesit do të plotësojë kërkesat e ONE Albania për akreditimin sipas kërkesave të përgjithshme për shëndetin dhe sigurinë të cilat mund të përfshijnë kontrolle rutinë kohë pas kohe në linjë me praktikatat standarte të ONE Albania.

2.1.2.4. ONE Albania do të njoftojë me shkrim kërkuesin e aksesit për çdo amendament ndaj këtyre kërkesave/rregullave për tu zbatuar gjatë vizitës punës në ambientet e ONE Albania.

2.2. Zona e centralit

2.2.1. ONE Albania kërkon që hyrja e kërkuesit të aksesit në centralet e tij të jetë e shoqëruar nga një punonjës i ONE Albania përveçse rastit të pikës 2.2.2. Kjo është në interes të kërkuesit të aksesit dhe ONE Albania në mënyrë që të sigurojnë asetet e tyre respektive nga dëmtimi. ONE Albania nga ana e tij do të punësojë vetëm personel të kualifikuar për të ofruar këtë shërbim.

2.2.2. Në rastet kur kërkuesi i aksesit ka plotësuar periudhën e provës, ONE Albania do të lejojë aksesin e pashoqëruar.

2.3. Disponueshmëria e shoqërimit

2.3.1 Aksesit (hyrja) e planifikuar

2.3.1.1 NMC e ONE Albania do të marrë në dorëzim të gjitha kërkesat për aksesin e kërkuesit të aksesit.

2.3.1.2 Kërkesat për akses (hyrje) mund të bëhen tek NMC gjatë orëve normale të punës, nga e hëna në të

premtë, të cilët do t'ia komunikojnë kërkesën personit të përshtatshëm të kualifikuar teknik.

2.3.1.3 Periudhat e njoftimit për aksesin e paplanifikuar janë të specifikuara në Marrëveshjen e Nivelit të Shërbimit (SLA) për bashkëvendosjen fizike në Aneks E, Seksioni A i kësaj Marrëveshjeje.

2.3.2 Aksesin (hyrja) i paplanifikuar

2.3.2.1 NMC e ONE Albania do të administrojë të gjitha kërkesat për hyrjen e kërkuar të aksesit.

2.3.2.2 Kërkesat për akses (hyrje) mund të bëhen mbi baza 24/7 për NMC e cila më pas do t'ia komunikojë kërkesën një personi të përshtatshëm të kualifikuar teknik.

2.3.3.3 Koha e përgjigjes për aksesin e paplanifikuar është e përcaktuar në Marrëveshjen e Nivelit të Shërbimit (SLA) për bashkëvendosjen fizike në Aneks E, Seksioni A i kësaj Marrëveshjeje

2.3.3. Aksesin (Hyrja) e pashoqëruar

2.3.3.1. Të gjitha kërkesat për hyrje të pashoqëruar mund të dorëzohen sipas Manualit të proceseve të industrisë për shërbimin e bashkëvendosjes fizike të ONE Albania.

2.3.3.2. Kërkesat për aksesin e pashoqëruar mund të bëhen gjatë orëve normale të punës.

2.3.3.3. Koha e përgjigjes për aksesin e pashoqëruar është e specifikuar në Manualin e Proceseve të industrisë për shërbimin e bashkëvendosjes fizike të ONE Albania.

ANEKS C

SKEDA E SHËRBIMIT 102

SHËRBIMI I AKSESIT TE PLOTË NË RRJETIN LOKAL (full unbundled access LLU Linjat e bakrit)

(Specifike: kur pika e aksesit eshte brenda ambienteve të ONE Albania (ish centralet telefonike të ONE Albania) për sa kohë do të ketë ende të tilla sipas përditësimit të Aneksit F)

Kjo skedë shërbimi është efektive nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje dhe do të mbetet në fuqi deri ne amendimin e saj ose si rrjedhim i një vendimi nga AKEP.

1. Përkufizime

Në këtë Aneks, referenca për një dispozitë ose Shtojcë përveç rastit kur është shprehur ndryshe, është dispozitë apo Shtojcë i këtij Aneksi. Fjalët dhe shprehjet kanë kuptimin e dhënë në Aneks A.

2. Përshkrimi i shërbimeve

Përshkrimi i shërbimeve jepet në Shtojca 1.

3. Kushtet dhe Termat

3.1. Linja e bakrit për akses të plotë në rrjetin lokal (ULMP) do të ofrohet nga ONE Albania nën kushtet e mëposhtme:

3.1.1. ONE Albania dhe kërkuesi i Aksesit do t'i përmbahen Planit të Menaxhimit të Frekuencave të linjës dypërcjellëse të bakrit.

3.1.2. Linja e bakrit për akses të plotë në rrjetin lokal te ONE Albania do t'i ofrohet kërkuesit të aksesit në përputhje më parashikimet e përshtatshme për Linjën e bakrit për akses të plotë në rrjetin lokal të nënvizuar në Manualin e Proceseve ndërmjet operatorëve për shërbimet e ONE Albania ULMP (linja e bakrit për akses të plotë në rrjetin lokal) dhe Line Sharing (aksesi i përbashkët në rrjetin lokal)

3.1.3. Linja e bakrit për akses të plotë në rrjetin lokal te ONE Albania do t'i ofrohet kërkuesit të aksesit vetëm me marrjen e Formularit të Porosisë të plotësuar në mënyrë korrekte sic është nënvizuar në Manualin e Proceseve për Linjën e bakrit për akses të plotë në rrjetin lokal

3.1.4. Linja e bakrit për akses të plotë në rrjetin lokal e përdorur në këtë produkt do të mbetet pronësi e ONE Albania.

3.1.5. Linja e bakrit për akses të plotë në rrjetin lokal do të jetë subjekt i kërkuesit të aksesit i cili merr të firmosur nga pajtimtari një Formular Autorizimi që përmban të gjitha detajet përkatëse për ofrimin e linjës së bakrit për akses të plotë në rrjetin lokal në emër të pajtimtarit. Formulari i Autorizimit të Pajtimtarit i përmendur më sipër do të ruhet në një dosje të sigurtë nga kërkuesi i aksesit për periudhën e kontratës. ONE Albania ka të drejtë, në mënyrë të arsyeshme, të kërkojë një kopje të këtij Formulari Autorizimi të Pajtimtarit herë pas here.

3.1.6. Kërkuesi i aksesit nuk do të caktojë ose të ndajë interesat e tij apo të drejtat në lidhje më linjën e bakrit për akses të plotë në rrjetin lokal. Për evitimin e dyshimit, kjo nuk përjashton kërkuesin e aksesit të ofrojë shërbime duke përdorur linjën e bakrit për akses të plotë në rrjetin lokal si bartës për produktet dhe shërbimet për rishitje ndaj palëve të treta.

3.1.7. Ofrimi i shërbimit të linjës së bakrit për akses të plotë në rrjetin lokal nga ONE Albania është subjekt i termave të SLA në Aneks E i kësaj Marrëveshje Aksesit.

3.1.8. Kategorizimi i linjës për linjën e bakrit për akses të plotë në rrjetin lokal do të ofrohet në përputhje me Manualin e Proceseve ndërmjet operatorëve për shërbimet e ONE Albania ULMP dhe Line Sharing.

4. Koha e Lëvrimit

4.1.1. Kohët e lëvrimit do të jenë sic parashikohen në Manualin e Proceseve ndërmjet operatorëve për shërbimet e ONE Albania të aksesit të plotë dhe të aksesit të përbashkët në rrjetin lokal (LLU).

5. Struktura e pagesave

5.1. Pagesat dhe/ose parimet (mënyrat) e faturimit (pagesave) për linjën e bakrit për akses të plotë në rrjetin lokal do të jenë sipas përcaktimeve në Listën e çmimeve të RUO të ONE Albania, duke përfshirë pagesat për Kategorizimin e Linjës.

SHTOJCA 1
E SKEDARIT TË SHËRBIMIT 102
PËRSHKRIMI I PRODUKTIT PËR LINJËN E BAKRIT PËR AKSES TË PLOTË NË RRJETIN
LOKAL

(Specifike: kur pika e aksesit eshte brenda ambienteve të ONE Albania (ish centralet telefonike të ONE Albania për sa kohë do të ketë ende të tilla sipas përditësimit të Aneksit F)

PËRMBAJTJA:

1. Hyrje

2. Përshkrimi i Produktit

2.1. Komponentët (përbërësit) e Produktit

2.1.1. MDF

2.1.2. Linja e bakrit

2.1.3. Ambjentet e pajtimtarit

3. Informacioni teknik i produktit

3.1. Menaxhimi i spektrit

4. Disponueshmëria e Produktit

5. Përgjegjësitë për shërbimin

6. Menaxhimi i shërbimit

6.1. Porosia

6.2. Ofrimi i shërbimit

6.3. Operimi dhe mirëmbajtja e rrjetit

6.4. Riparimi i defekteve

6.5. Nivelet e shërbimit

Shtojca 1: Parametrat e MDF (blloku në MDF i kërkuesit të aksesit)

Shtojca 2: Parametrat e linjës fizike të bakrit

Përmbledhje e standarteve të transmetimit dhe sinjalizimit

Limiti i transmetimit

Limiti i sinjalizimit

Standartet e rrjetit lokal

Limitet e sinjalizimit dhe ushqimit

Parametra Fizike:

Izolimi i linjës


Rezistenca maksimale e linjës
Rezistenca e prizës telefonike (Modularit Jack)
Zbutja e shtrembërimeve (distortion)
Shpejtësia e të dhënave
Zhurma e zakonshme
Zhurma e impulsit
Niveli maksimal i transmetimit

1. Hyrje

- 1.1. Ky dokument përcakton përshkrimin e produktit të rënë dakord nga industria për linjën e bakrit për akses të plotë në rrjetin lokal.
- 1.2. Proçeset që mbështesin implementimin e shërbimeve janë të nënvizuara në Manualin e Proceseve ndërmjet operatorëve për shërbimet e ONE Albania ULMP dhe Line Sharing.

2. Përshkrimi i Produktit

- 2.1. Linja e bakrit për akses të plotë në rrjetin lokal (ULMP) është një lidhje e linjës metalike dypërcjellëse midis bllokut të kërkuesit të aksesit në permutatorin e MDF dhe pikës terminale të rrjetit (NTU), ose pika terminale e rrjetit kur nuk ka NTU, në ambientet e pajtimtarit.
- 2.2. Një linjë metalike i referohet:
 - 2.2.1. Linjave ku ofrohet shërbimi ekzistues i PSTN/ISDN BRA
 - 2.2.2. Linja me sinjal të butë (dial tone)
 - 2.2.3. Linjave rezervë që ekzistojnë midis MDF dhe NTU/NTP në ambientet e pajtimtarit kur është e mundshme, dhe të cilat në vijim të shqyrtimit të vëndit, mund të plotësohen me ura përcjellëse (jumpers), nga një tel (drop wire) ose duke lidhur (jumping) në nivelin e kabinetit në rrugë.
- 2.3. Pikat e demarkacionit janë blloku i kërkuesit të aksesit në permutatorin e MDF dhe ndërfaqes së pajtimtarit të NTU/NTP.



3. Komponentët e Produktit

3.1. MDF

- 3.1.1. Kërkuesi i aksesit do të ketë akses në fasilitetin e linjës së bakrit për përdorim të përbashkët në blloqet

e tyre të dedikuara në permutatorin e MDF. Ky bllok i MDF do të mundësohet nga kërkuesi i aksesit në përputhje me specifikimet e ONE Albania, dhe do të instalohet në MDF nga ONE Albania. Kërkuesi i aksesit do të identifikojë në këtë bllok, permutatorin, linjën dhe kopjet e numrave. Mundësimi i urës lidhëse (jumperi) midis krahut të linjës së MDF-së dhe bllokut të kërkuesit të aksesit në permutatorin e MDF-së do të mundësohet nga ONE Albania. Mundësimi i kabllit lidhës midis bllokut të kërkuesit të aksesit në permutatorin e MDF dhe hapësirës së bashkëvendosjes fizike të tyre është e detajuar në Manualin Teknik për bashkëvendosjen fizike.

3.2. Linja e bakrit (metalike)

3.2.1. Linja lokale metalike është një çift kopjesh bakri dypërcjellëse që mundëson lidhjen nga MDF deri në njësinë terminale të rrjetit (NTU) në ambientet e pajtimtarit, ose pikës terminale të rrjetit (NTP) kur nuk ekziston NTU në ambientet e pajtimtarit.

3.3. Ambientet e pajtimtarit

3.3.1. Vendi i pajtimtarit i njësisë terminale të rrjetit (NTU) ose pika terminale e rrjetit (NTP) është pika finale e përgjegjësive së ONE Albania për linjën e bakrit për akses të plotë në rrjetin lokal.

3.3.2. Në ambientet e pajtimtarit kërkuesi i aksesit do të aksesojë linjën e bakrit nëpërmjet njësisë terminale të rrjetit NTU-se standarte të ONE Albania (ose pikës terminale të rrjetit NTP) (kur nuk ka NTU). Kur duhet të instalohet një pajisje NTU aty ku nuk ekziston demarkacion i identifikueshëm, ONE Albania do t'i ofrojë kërkuesit të aksesit një njësi terminale të rrjetit (NTU) të standartizuar me marrëveshjen për tu instaluar dhe testuar nga kërkuesi i aksesit, subjekt i standarteve për instalimin të rena dakort. Specifikimet e NTU/NTP janë bashkëngjitur në Shtojcën 3.

3.3.3. Mundësimi, instalimi, zëvendësimi dhe mirëmbajtja e çdo pajisje/lidhje shtesë në anën e pajtimtarit të NTU/NTP e kërkuar për të ofruar shërbimet e kërkuesit të aksesit, përdoruesi fundor do të jetë përgjegjësi e kërkuesit të aksesit.

4. Informacioni Teknik i Produktit

- Parametrat e ndërfaqes së MDF dhe të ndërfaqes NTU të detajuara në Shtojcën 1
- Parametrat e linjës së bakrit - të detajuara në Shtojcën 2

4.1. Menaxhimi i spektrit

4.1.1. Ofrimi i linjës së bakrit për akses të plotë në rrjetin lokal për kërkuesin e aksesit do të jetë në varësi të përputhshmërisë me Planin e Menaxhimit të Frekuencave të linjave dypërcjellëse të bakrit.

5. Disponueshmëria e produktit

5.1. Linjat e bakrit të disponueshme për akses janë të përcaktuara në përshkrimin e produktit në seksionin 2.

5.2. Përshtatshmëria e linjës së bakrit të disponueshme do të varet nga shqyrtimet individuale. Arsyet për një shqyrtim “të dështuar” do t'i jepen kërkuesit të aksesit respektiv.

5.3. Linja e bakrit nuk do të ofrohet nëse kjo linjë fizike është planifikuar për tu hequr brenda 3 vjetëve.

5.4. Linja fizike e bakrit nuk do të jetë e disponueshme nëse ka arritur kapacitetin praktik maksimal.

5.5. Linja fizike e bakrit nuk do të jetë e disponueshme kur përdoruesi fundor nuk

shërbehet me linjë bakri por me PCM (MUX) dhe nuk ekziston një linjë bakri rezervë ndërmjet pikës së Lidhjes përkatëse dhe përdoruesit fundorë.

6. Përgjegjësitë e shërbimit

- 6.1. Pika e parë e kontaktit për një përdorues fundorë të një linje bakri për përdorim të përbashkët do të jetë kërkuesi i aksesit që ofron shërbimet. Kërkuesi i aksesit duhet të ketë aftësinë të lokalizojë defektet dhe t'ja kalojë ONE Albania-it për riparim, defekte të lokalizuara tek linja e bakrit për akses të plotë në rrjetin lokal.
- 6.2. ONE Albania do të ketë përgjegjësinë për mundësimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e linjës së bakrit për përdorim të përbashkët. Marrëveshja e Nivelit të Shërbimit (SLA) brenda termave të kontratës mes ONE Albania dhe kërkuesit të aksesit që ofron shërbimin në lidhje me procesin e mundësimit, riparimit dhe mirëmbajtjes është bashkëngjitur në Aneks E, seksioni B i kësaj Marrëveshje Aksesit.

7. Menaxhimi i Shërbimit

Parametrat e menaxhimit të shërbimit, objektivat, procedurat dhe proceset për linjën e bakrit për përdorim të përbashkët janë të detajuara në Manualin e Proçeseve ndërmjet operatorëve për shërbimet e ONE Albania ULMP dhe Line Sharing

7.1. Porosia

7.1.1. Ndërfaqja midis kërkuesit të aksesit dhe ONE Albania për depozitimin e porosive do të jetë sipas përcaktimeve në Manualin e Proçeseve ndërmjet operatorëve për shërbimet e ONE Albania ULMP dhe Line Sharing.

7.2. Dhënia e shërbimit

7.2.1. Proçeset për dhënien e shërbimit do të jenë sipas përcaktimeve në Manualin e Proçeseve ndërmjet operatorëve për shërbimet e ONE Albania ULMP dhe Line Sharing.

7.3. Operimi dhe mirëmbajtja e rrjetit

7.3.1. Proçeset për operimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit do të jenë sipas përcaktimeve në Manualin e Proçeseve ndërmjet operatorëve për shërbimet e ONE Albania ULMP dhe Line Sharing.

7.4. Riparimi i defekteve

7.4.1. Proçeset për riparimin e defekteve do të jenë sipas përcaktimeve në Manualin e Proçeseve ndërmjet operatorëve për shërbimet e ONE Albania ULMP dhe Line Sharing.

7.5. Nivelet e shërbimit

7.5.1. Nivelet specifike të shërbimit do të jenë sipas përcaktimeve në Manualin e Proçeseve ndërmjet operatorëve për shërbimet e ONE Albania ULMP dhe Line Sharing.

Shtojca 1: Parametrat e MDF (blloku në MDF i kërkuesit të aksesit)

Bloqet e mëposhtme aktualisht përdoren në terminimin e kablllove në MDF. Specifikimet e bllokut të MDF për një central të veçantë do të jepen si pjesë e Ofertës për vendin.

1. Ndërtimi

- 1.1 Bloqet e terminimit të rrjetit duhet të jenë të përbëra nga një strukturë prej metali të lehtë dhe të fortë në të cilën duhet të montohen bloqet fundore ku terminohet rrjeti i aksesit të ONE Albania si dhe rrjeti i kërkuesit të aksesit.
- 1.2 Bloqet e terminimit të rrjetit duhet të jenë module me kapacitet minimal 10 kopje. Në këto blloqe duhet të sigurohet lehtësisht ndarja fizike që dallon saktë për efekt matje pjesën e linjës së rrjetit të ONE Albania nga rrjeti i kërkuesit të aksesit.
- 1.3 Terminalet individuale të kopjeve (pikat e lidhjeve të kopjeve në modul) në çdo modul duhet të kenë numrat përkatës identifikues që fillojnë nga 1 deri në 10. Terminali i çdo përcjellësi (pikat e lidhjes së përcjellesit në modul) duhet të jetë i përshtatshëm për të lidhur përcjellesa me diametër 0.4-0.6 mm.
- 1.4 Në të dy anët e çdo moduli duhet të ketë unaza udhëzuese që mbështesin sistemimin e fijeve që lidhen në modul.
- 1.5 Korniza e pasme e modulit duhet të jetë e përshtatshme për tu fiksuar me vida mbi një strukturë të sigurt dhe të stabilizuar. Një vidë / morseteri tokëzimi duhet të jetë e pranishme në afërsi të vendit të montimit të NTU.
- 1.6 Çdo modul NTU 10 kopjesh duhet të jetë i pajisur me një kapak plastik transparent që pengon grumbullimin e pluhurave brenda modulit (hapësirave ndërmjet fijeve të lidhura).
- 1.7 Çdo kapak duhet të ketë mbajtëse estetike të ndryshueshme / lëvizshme në të cilën shkruhet numeracioni përkatës.

2. Parametrat elektrike

- 2.1 Fortësia e dielektrikut duhet të jetë minimalisht 20,000 VAC për një interval kohor prej 60 sekondash, pa pësuar çpim të dielektrikut.
- 2.2 Kapaciteti ndërmjet një çifti terminimi nuk duhet t'i kalojë 5 pf.
- 2.3 Rezistenca e izolimit ndërmjet dy çifteve terminuese fqinje duhet të jetë $\geq 100 \text{ M}\Omega$ e matur nën tensionin 500 VDC dhe pas 60 sekondash.
- 2.4 Kushtet normale të punës janë të garantuara në temperaturat nga $-40 \text{ }^\circ\text{C}$ deri në $+80 \text{ }^\circ\text{C}$.

Shtojca 2: Parametrat e linjës fizike të bakrit

Aksesi në rrjetin kabllor të ONE Albania sigurohet nëpërmjet linjave fizike me të dhënat si me poshtë:

Materiali i përcjellësive të linjës: Bakër

Diametri i përcjellësit: 0.4 mm; 0.5 mm; 0.6 mm; (jo gjithmonë këta diametra)

Karakteristikat elektrike të rrjetit të aksesit janë:

1. Rezistenca e përcjellësive:

1.1. Vlera maksimale e rezistencës së përcjellësive e matur në 20° C

Diametri i përcjellësit (mm)	Rezistenca (Ω / km)	
	Mesatare	Individuale
0.4	144	150
0.5	90	92
0.6	64	67

1.2. Kufijtë e çballancimit të rezistencës janë:

Diametri i përcjellësit (mm)	Maksimumi i çballancimit të rezistencës (%)	
	Mesatar	Maksimal
0.4	1.0	2.5
0.5	0.85	2.2
0.6	0.75	2.0

2. Rezistenca e izolimit të linjës së aksesit plotëson kushtet si vijon:

2.1. Rezistenca e izolimit ndërmjet fijeve për çdo kopje është $\geq 500M\Omega$

2.2. Rezistenca e izolimit për çdo fije te kopjes me token është $\geq 500M\Omega$

3. Shuarjet e punës në linjën e akses rrjetit të ONE Albania është $\leq 7db$.

3.1. Shuarjet e punës do të maten në frekuencat 1Khz dhe 1Mhz. Vlerat e matura, nëse korrektohen për temperaturë 45° C nuk duhet t'i kalojnë vlerat e treguara ne tabelën e më poshtë:

Diametri i përcjellësit (mm)	Shuarja (dB / km)	
	1 KHz	1 MHz
0.4	1.81	27.5
0.5	1.45	22.7
0.6	1.15	17.0

Toleranca maksimale për vlerat individuale lejohet deri në + / - 10 %.

ANEKS C
SKEDA E SHËRBIMIT 103
AKSESI I PËRBASHKËT NË RRJETIN LOKAL TE LINJAVE TE BAKRIT (SHARED ACCESS
LLU)

(Specifike: kur pika e aksesit është brenda ambienteve të ONE Albania (ish centralet telefonike të ONE Albania) për sa kohë do të ketë ende të tilla sipas përditësimit të Aneksit F)

Kjo skedë shërbimi është efektive nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje dhe do të mbetet në fuqi deri në amendimin e saj ose si rrjedhim i një vendimi nga AKEP.

1. Përkufizime

1.1. Në këtë Aneks, referenca për një dispozitë ose Shtojcë përvec rastit kur është shprehur ndryshe, është dispozitë apo Shtojcë i këtij Aneksi. Fjalët dhe shprehjet kanë kuptimin e dhënë në Aneks A.

2. Përshkrimi i shërbimeve

2.1. Përshkrimi i shërbimeve jepet në Shtojca 1

3. Kushtet dhe Termat

3.1. Linja e bakrit për përdorim të përbashkët do të ofrohet nga ONE Albania nën kushtet e mëposhtme:

3.1.1. ONE Albania dhe kërkuesi i Aksesit do t'i përmbahen Planit të Menaxhimit të Frekuencave të linjës dypërcjellëse të bakrit.

3.1.2. Aksesit i përbashkët në rrjetin lokal të ONE Albania do t'i ofrohet kërkuesit të aksesit në linjë me parashikimet e përshtatshme për Linjën e bakrit për përdorim të përbashkët të nënvizuar në Manualin e Proçeseve ndërmjet operatorëve për shërbimet e ONE Albania te aksesit te plote dhe aksesit te përbashkët në rrjetin lokal (referuar si Manuali i Proçeseve për LLU).

3.1.3. Aksesit i përbashkët në rrjetin lokal të ONE Albania do t'i ofrohet kërkuesit të aksesit vetëm me marrjen e Formularit të Porosisë të plotësuar në mënyrë korrekte siç është nënvizuar në Manualin e Proçeseve për LLU

3.1.4. Kërkuesi i aksesit nuk do të caktojë ose të ndajë interesat e tyre apo të drejtat në lidhje me linjën e bakrit për përdorim të përbashkët. Për evitimin e dyshimit, kjo nuk përjashton kërkuesin e aksesit të ofrojë shërbime duke përdorur aksesin e përbashkët në rrjetin lokal si bartës për produktet dhe shërbimet për rishitje ndaj palëve të treta.

3.1.5. Linja e bakrit e përdorur për shërbimin e aksesit të përbashkët në rrjetin lokal të ONE Albania do të mbetet pronësi e ONE Albania.

3.1.6. Shërbimi i aksesit të përbashkët në rrjetin lokal do të jetë subjekt i kërkuesit të aksesit i cili merr të firmosur nga pajtimtari një Formular Autorizimi të Pajtimtarit që përmban të gjitha detajet përkatëse për ofrimin e linjës së bakrit për përdorim të përbashkët në emër të pajtimtarit.

3.1.7. Formulari i Autorizimit të Pajtimtarit i përmendur më sipër do të ruhet në një dosje të sigurtë nga kërkuesi i aksesit për periudhën e kontratës. ONE Albania ka të drejtë, brënda arsyes, të kërkojë një kopje të këtij Formulari Autorizimi të Pajtimtarit nga koha në kohë. Kjo mund të mundësohet me fax ose me postë.

3.1.8. Mundësimi i shërbimit të aksesit të përbashkët në rrjetin lokal nga ONE Albania është subjekt i termave

të SLA në Aneks E të kësaj Marrëveshje Aksesi.

- 3.1.9. ONE Albania do t'i mundësojë kërkuarit të aksesit, me nënshkrimin e marrëveshjes së konfidencialitetit në Aneks D, informacionin e nënvizuar në Aneks G në lidhje me rrjetin e ONE Albania.
- 3.1.10 Kategorizimi i linjës për aksesin e përbashkët në rrjetin lokal do të ofrohet në përputhje me Manualin e Proçeseve për LLU .

4. Koha e Lëvrimit

- 4.1.1. Kohët e lëvrimit do të jenë siç parashikohen në Manualin e Proçeseve për LLU.

5. Struktura e pagesave

- 5.1. Pagesat dhe/ose parimet (mënyrat) e faturimit (pagesave) për linjën e bakrit për përdorim të përbashkët do të jetë sipas përcaktimeve në Listën e çmimeve të RUO të ONE Albania, duke përfshirë pagesat për Kategorizimin e Linjës.

SHTOJCA 1
I SKEDËS SË SHËRBIMIT 103
PËRSHKRIMI I SHËRBIMIT PËR AKSESIN E PËRBASHKËT NË RRJETIN LOKAL

(Specifike: kur pika e aksesit është brenda ambienteve të ONE Albania (ish centralet telefonike të ONE Albania) për sa kohë do të ketë ende të tilla sipas përditësimit të Aneksit F)

1. Hyrje

2. Përshkrimi i Produktit

2.1. Komponentët (përbërësit) e Produktit

2.1.1. Pajisja ADSL

2.1.2. ODF

2.1.3. MDF

2.1.4. Linja lokale

2.1.5. Ambientet e pajtimtarit

3. Informacioni teknik i produktit

3.1. Menaxhimi i spektrit

4. Disponueshmëria e Produktit

5. Përgjegjësitë për shërbimin

6. Menaxhimi i shërbimit

6.6. Porosia

6.7. Ofrimi i shërbimit

6.8. Operimi dhe mirëmbajtja e rrjetit

6.9. Riparimi i difekteve

6.10. Nivelet e shërbimit

Shtojca 1 - Parametrat e MDF (blloku në MDF i kërkuesit të aksesit)

Shtojca 2 - Parametrat e linjës fizike të bakrit

Përmbledhje e standarteve të transmetimit dhe sinjalizimit

Limiti i transmetimit:

Limiti i sinjalizimit

Limitet e sinjalizimit dhe ushqimit

Parametra Fizike:

Izolimi i linjës

Rezistenca maksimale e linjës

Rezistenca e prizës telefonike (Modularit Jack)
Zbutja e shtrembërimeve (distortion)
Shpejtësia e të dhënave
Zhurma e zakonshme
Zhurma e impulsit
Niveli maksimal i transmetimit

1. Hyrje

- 1.1. Ky dokument përcakton përshkrimin e produktit të rënë dakort nga industria për aksesin e përbashkët në rrjetin lokal.
- 1.2. Proçeset që mbështesin implementimin e shërbimeve janë të nënvizuara në Manualin e Proçeseve ndërmjet operatorëve për shërbimet e ONE Albania ULMP dhe Line Sharing.
- 1.3. Ky përshkrim i produktit do të adaptohet si informacion i ri, ashtu siç kërkesat e reja apo ndryshimet teknologjike kërkojnë amendime përkatëse.

2. Përshkrimi i Produktit

Produkti i aksesit të përbashkët në rrjetin lokal lejon një shërbim DSL ofruar nga një kërkues aksesi, të integrohet mbi të njëjtën linjë dypërcjellëse si shërbimi me pakicë i ONE Albania PSTN ose SB-WLR. Pika e demarkacionit për ONE Albania do të jetë njësisia terminale e rrjetit (NTU) në ambientet e pajtimtarit dhe blloqet e lidhjes së kërkuesit të aksesit në MDF.

Kërkuesi i aksesit do të marrë me qera fasilitetin e aksesit të përbashkët në rrjetin lokal nga ONE Albania.

Nëse përdoruesi fundor ndërpret shërbimin zanor PSTN të ONE Albania, ONE Albania do të ndërmarrë veprime për të shkëputur shërbimin zanor PSTN dhe do të njoftojë kërkuesin e aksesit për një shkëputje të tillë. Në këto rrethana nëse kërkuesi i aksesit dëshiron të mbajë shërbimin ADSL, ONE Albania do ta rikonfigurojë linjën në aksesin e përbashkët në rrjetin lokal “stand-alone” për kërkuesin e aksesit. Në të kundërt, të gjitha shërbimet në atë linjë do të shkëputen (sipas Manualit të Proçeseve ndërmjet operatorëve për shërbimet e ONE Albania ULMP dhe Line Sharing).

Diagrama 1:

2.1. Komponentët e Produktit

2.1.1. Pajisja DSL

2.1.1.1. Mundësia për të integruar zërin dhe shërbimin DSL do të mundësohet nga rack-u DSL i kërkuesit të aksesit. Pajisja e kërkuesit të aksesit do të instalohet në ambientet e ONE Albania sipas përshkrimit të produktit të bashkëvendosjes fizike.

2.1.1.2. Metodatat aktuale për ofrimin janë sipas detajimeve në Manualin e Proçeseve ndërmjet operatorëve për shërbimet e ONE Albania ULMP dhe Line Sharing. Shërbimi i zërit nga ONE Albania do të lidhet nga blloku në MDF në anën e komutimit (centralit) të ONE Albania me bllokun e kërkuesit të aksesit. Një kabëll lidhës nga ky bllok tek pajisja DSL do të mundësojë shërbimin e

zërit të integrohet me shërbimin DSL. Blloku i kërkuesit të aksesit do të lidhet (jumpered) në anën e linjave të MDF për të aksesuar linjën e bakrit deri në premiset e pajtimtarit.

2.1.1.3. Kërkuesi i aksesit do të mundësojë kabllot lidhës nga pajisja DSL tek blloqet e tyre në MDF si përshkruhet në përshkrimin e produktit të bashkëvendosjes fizike. Kjo vazhdimësi duhet të jetë në vënd përpara se të bëhet një porosi nga kërkuesi i aksesit për aksesin e përbashkët në linjën e bakrit.

2.1.1.4. Aksesit i përbashkët në linjën e bakrit do të lejohet vetëm aty ku shërbimet e zërit të ONE Albania i qëndrojnë rezidencës së centralit telefonik të ONE Albania.

2.1.1.5. Kriteret e shoqëruara me instalimin e pajisjes DSL do të përcaktohen si pjesë e përshkrimit të produktit të bashkëvendosjes fizike.

2.1.2. ODF

2.1.2.1. Pajisja DSL e kërkuesit të aksesit do të lidhet me një ODF (optical distribution frame) siç është e detajuar në Manualin Teknik për bashkëvendosjen fizike.

2.1.3. MDF

2.1.3.1. ONE Albania do të mundësojë hapësirën në MDF për blloqet e kërkuesit të aksesit.

2.1.3.2. ONE Albania do të mundësojë “jumpers” lidhës në MDF nga:

2.1.3.2.1. Blloku i zërit të ONE Albania në anën e komutimit (centralit) të MDF tek blloku i kërkuesit të aksesit dhe nga

2.1.3.2.2. Blloku i kërkuesit të aksesit në anën e komutimit (centralit) të MDF-së në bllokun në anën e linjës kështu që kërkuesi i aksesit mund të aksesojë linjën metalike dypërcjellëse.

2.1.3.3. Në rastet e disponueshmërisë së kufizuar tek MDF për mundësimin e blloqeve të kërkuesit nga kërkuesi i aksesit, hapësira do t'i caktohet sipas parimit kush vjen i pari, shërbehet i pari.

2.1.4. Linja lokale (Local loop)

2.1.4.1. Linja lokale është një linjë fizike metalike dypërcjellëse që mundëson një lidhje nga MDF tek njësisia terminale e rrjetit në ambjentet e pajtimtari.

2.1.5. Ambjentet e pajtimtarit

2.1.5.1. Ana e pajtimtarit e njësisë terminale të rrjetit të ONE Albania është pika finale e përgjegjësisë së ONE Albania për produktin e aksesit të përbashkët në linjën e bakrit.

2.1.5.2. Në ambjentet e pajtimtarit, kërkuesi i aksesit do të aksesojë linjën e përbashkët nëpërmjet njësisë terminale të rrjetit (NTU) të ONE Albania. Aty ku nuk është e nevojshme të instalohet NTU, procedura për mundësimin dhe instalimin do të jetë e detajuar në Manualin e Proçeseve ndërmjet operatorëve për shërbimet e ONE Albania ULMP dhe Line Sharing.

2.1.5.3. Ofrimi dhe mirëmbajtja e klientëve të lidhur me shërbimin ADSL si dhe ofrimi dhe instalimi i çdo

pajisje për t'i ofruar pajtimtarit shërbimin ADSL do të jetë përgjegjësi e kërkuarit të aksesit. Zëvendësimi apo ndryshimet në linjën ekzistuese të pajtimtarit për të instaluar pajisjen e përshtatshme do të jetë gjithashtu përgjegjësi e kërkuarit të aksesit.

3. Informacioni teknik i produktit

- 3.1. Parametrat për ndërfaqen e MDF janë të detajuara në Shtojcën 1
- 3.2. Parametrat e linjës fizike metalike dypërcjellëse janë të detajuara në Shtojcën 2
- 3.3. Parametrat për ndërfaqen e NTU janë të detajuara në Shtojcën 3

3.4. Menaxhimi i spektrit

- 3.4.1. Ashtu si ONE Albania edhe kërkuari i aksesit do të pajtohen me Planin e Menaxhimit të Frekuencave të linjave dypërcjellëse të bakrit.

4. Disponueshmëria e Produktit

- 4.1. Linjat e disponueshme për aksesin e përbashkët janë linjat e PSTN dhe ISDN që janë aktualisht në shërbim. Parametrat e linjës metalike dypërcjellëse janë të specifikuar në Shtojcën 2.
- 4.2. Përshtatshmëria e linjës metalike do të jetë në varësi të shqyrtimeve individuale.
- 4.3. Linja e bakrit nuk do të ofrohet nëse kjo linjë fizike është planifikuar për tu hequr brenda 3 vjetëve.
- 4.4. Linja fizike e bakrit nuk do të jetë e disponueshme nëse ka arritur kapacitetin teknik maksimal.
- 4.5. Linja fizike e bakrit nuk do të jetë e disponueshme kur përdoruesi fundor nuk shërbehet me linjë bakri por me PCM (MUX) dhe nuk ekziston një linjë bakri rezervë ndërmjet pikës së Lidhjes përkatëse dhe përdoruesit fundorë.

5. Përgjegjësitë e shërbimit

- 5.1. ONE Albania do të ketë përgjegjësi për shërbimet e ONE Albania për produktin e aksesit të përbashkët në linjën e bakrit shërbyer kërkuarit të aksesit, dhe për ofrimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e linjës metalike dypërcjellëse.
- 5.2. Kërkuari i aksesit duhet të sigurojë integritetin e vazhdueshëm të shërbimit të ONE Albania në produktin e aksesit të përbashkët në linjën e bakrit gjatë dhe në vijim të instalimit së pajisjeve/shërbimeve sipas marrëveshjes së aksesit. Nëse pajtimtari nuk është i kënaqur me shërbimet e ONE Albania, që ndodhin pas instalimit të pajisjeve/shërbimeve, kërkuari i aksesit duhet të korrigjojë problemet e shërbimit brenda një kohe të rënë dakord ose ONE Albania rezervon të drejtën të rivendosë instalimin në statusin origjinal.
- 5.3. Në lidhje me ofrimin e shërbimeve DSL, kjo do të jetë përgjegjësi e kërkuarit të aksesit.
- 5.4. Në rast të difekteve pas instalimit raportuar tek kërkuari i aksesit, kërkuari i aksesit duhet më parë të ndreqë defektin nëse defekti ndodh brenda pajisjes së tyre. Nëse defekti nuk ndodh brenda pajisjes së tyre, kërkuari i aksesit duhet ta lokalizojë defektin në linjën e bakrit të ONE Albania përpara se ta raportojë defektin tek ONE Albania për riparim.

- 5.5. Ndërprerjet e planifikuara dhe të rëna dakort për shërbimet/pajisjet e kërkuarit të aksesit të cilat ndikojnë në shërbimet e ONE Albania në produktin e aksesit të përbashkët në linjën e bakrit nuk duhet të ndodhin gjatë orarit normal të aktivitetit.
- 5.6. Kur shërbimet/pajisjet e kërkuarit të aksesit ndikojnë në shërbimet e ONE Albania për një pajtimtar, ONE Albania rezervon të drejtën për të hequr produktin e aksesit të përbashkët në linjën e bakrit për kërkuarin e aksesit dhe kështu të rivendosë shërbimet e ONE Albania pajtimtarit të tij. Kërkuari i aksesit është përgjegjës për koston e punës së shkaktuar në këtë rast.
- 5.7. Kur kërkuari i aksesit konfirmon se pajisjet/shërbimet janë pa defekt, atëherë kërkuari i aksesit mund të aplikojë tek ONE Albania për të rivendosur produktin e aksesit të përbashkët në linjën e bakrit. ONE Albania do të rivendosë produktin e aksesit të përbashkët në linjën e bakrit me një pagesë që do të paguhet nga kërkuari i aksesit.
- 5.8. Kërkuari i aksesit duhet të sigurojë dhe garantojë privatësinë dhe konfidencialitetin e shërbimeve të ONE Albania për produktin e aksesit të përbashkët në linjën e bakrit mbi pajisjet e tyre.
- 5.9. Marrëveshja e nivelit të shërbimit (SLA) brenda termave të kontratës midis ONE Albania dhe kërkuarit të aksesit për ofrimin (mundësimin), riparimin dhe mirëmbajtjen e produktit të aksesit të përbashkët në linjën e bakrit është bashkëngjitur në Aneks E, seksioni B i Marrëveshjes së Aksesit.

6. Menaxhimi i shërbimit

Parametrat e menaxhimit të shërbimit, procedurat e planifikuara dhe proceset për aksesin e përbashkët në linjën e bakrit janë të detajuara në Manualin e Proçeseve ndërmjet operatorëve për shërbimet e ONE Albania ULMP dhe Line Sharing.

6.1. Porosia

6.1.1. Ndërfaqja midis kërkuarit të aksesit dhe ONE Albania për depozitimin e porosive do të jetë sipas detajimeve në Manualin e Proçeseve ndërmjet operatorëve për shërbimet e ONE Albania ULMP dhe Line Sharing.

6.2. Ofrimi i shërbimit

6.2.1. Proçeset për ofrimin (mundësimin) e shërbimit do të jetë sipas detajimeve në Manualin e Proçeseve ndërmjet operatorëve për shërbimet e ONE Albania ULMP dhe Line Sharing.

6.3. Operimi dhe mirëmbajtja e rrjetit

6.3.1. Proçeset për operimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit do të jetë sipas detajimeve në Manualin e Proçeseve ndërmjet operatorëve për shërbimet e ONE Albania ULMP dhe Line Sharing.

6.4. Riparimi i difekteve

6.4.1. Për riparimin e difekteve do të vepohet sipas detajimeve në Manualin e Proçeseve ndërmjet operatorëve për shërbimet e ONE Albania ULMP dhe Line Sharing.

6.5. Nivelet e shërbimit

6.5.1. Nivele shërbimi specifike dhe proceset do të jenë sipas detajimeve në Manualin e Proçeseve ndërmjet operatorëve për shërbimet e ONE Albania ULMP dhe Line Sharing.

**Shtojca 1 – Parametrat e MDF (Bloku në MDF i kërkuesit të aksesit)
- e njëjtë me shtojcën 1 në shërbimin 102**

Shtojca 2 - Parametrat e linjës fizike të bakrit

Aksesi në rrjetin kabllor të ONE Albania sigurohet nëpërmjet linjave fizike me të dhënat si me poshtë:

Materiali i përcjellësave të linjes: Bakër

Diametri i përcjellësit: 0.4 mm; 0.5 mm; 0.6 mm; (jo gjithmonë janë keta diametra) Karakteristikat elektrike të rrjetit të aksesit janë:

1. Rezistenca e përcjellësave:

1.1. Vlera maksimale e rezistencës së përcjellësave e matur në 20° C

Diametri i përcjellësit (mm)	Rezistenca (Ω / km)	
	Mesatare	Individuale
0.4	144	150
0.5	90	92
0.6	64	67

1.2. Kufijtë e çballancimit të rezistencës janë:

Diametri i përcjellësit (mm)	Maksimumi i çballancimit të rezistencës (%)	
	Mesatar	Maksimal
0.4	1.0	2.5
0.5	0.85	2.2
0.6	0.75	2.0

2. Rezistenca e izolimit të linjes së aksesit plotëson kushtet si vijon:

2.1. Rezistenca e izolimit ndërmjet fijeve për çdo kopje është $\geq 500M\Omega$

2.2. Rezistenca e izolimit për cdo fije të kopjes me tokën është $\geq 500M\Omega$

3. Shuarjet e punës në linjën e akses rrjetit të ONE Albania është $\leq 7db$.

3.1. Shuarjet e punës do të maten në frekuencat 1Khz dhe 1Mhz. Vlerat e matura, nëse korrektohen për temperature 45° C nuk duhet t'i kalojnë vlerat e treguara në tabelën më poshtë.

Diametri i përcjellësit (mm)	Shuarja (dB / km)	
	1 KHz	1 MHz
0.4	1.81	27.5
0.5	1.45	22.7
0.6	1.15	17.0

Toleranca maksimale për vlerat individuale lejohet deri në + / - 10 %.

ANEKS C
SKEDA E SHËRBIMIT 104
AKSESI NË RRJETIN LOKAL – MSAN-e

Kjo skedë shërbimi është efektive nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje dhe do të mbetet në fuqi deri në amendimin e saj ose si rrjedhim i një vendimi nga AKEP.

1. Përkufizime

1.1. Në këtë Aneks, referenca për një dispozitë ose Shtojcë përveç rastit kur është shprehur ndryshe, është dispozitë apo Shtojcë i këtij Aneksi. Fjalët dhe shprehjet kanë kuptimin e dhënë në Aneks A.

2. Përshkrimi i shërbimeve

2.1. Përshkrimi i shërbimeve jepet në Shtojca 1.

3. Kushtet dhe Termat

3.1. Aksesit në rrjetin lokal – MSAN-e do të ofrohet nga ONE Albania nën termat e mëposhtëm:

3.1.1. Aksesit në rrjetin lokal do t'i ofrohet kërkuarit të aksesit në një linjë me dispozitat urdhëruese të përshtatshme për aksesin në rrjetin lokal të nënvizuara në Manualin e Proçeseve ndërmjet operatorëve për aksesin në rrjetin lokal e zhvilluar nga Industria. (këtu e më poshte referuar si Manuali i proçeseve për aksesin në rrjetin lokal-MSAN-e)

3.1.2. Aksesit në rrjetin lokal do t'i ofrohet kërkuarit të aksesit vetëm me marrjen e Formularit të Porosisë për aksesin në rrjetin lokal të plotësuar në mënyrë korrekte siç paraqitet në Manualin e proçeseve për aksesin në rrjetin lokal.

3.1.3. Çdo Formular Porosie i depozituar nga kërkuari i aksesit për aksesin në rrjetin lokal do t'i referohet një kabinetit/ndërtese të veçantë të ONE Albania.

3.1.4. Kërkuari i aksesit do të jetë përgjegjës për instalimin, operimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të tij brenda kabinetit/ndërtesës.

3.1.5. Aksesit në rrjetin lokal do të jetë brenda një kabinetit/ndërtese ekzistuese të ONE Albania. ONE Albania nuk do të ndërtojë strukturalisht ndonjë kabinet/ndërtesë tjetër. Përcaktimi i hapësirës në kabinetet/ndërtesat e ONE Albania do të jenë në përputhje me planet e rrjetit të ONE Albania.

3.1.6. Hapësira brenda kabineteve/ndërtesave të ONE Albania do të përcaktohet sipas parimit kush vjen i pari shërbehet i pari, vënë në dispozicion siç përshkruhet në Proçesin e manualeve për aksesin në rrjetin lokal.

3.1.7. Nëse shërbimi nuk mund të ofrohet për arsye të fizibilitetit/realizueshmërisë ose nevojës për të ruajtur integritetin e rrjetit ose mungesës së kapaciteteve, për shkak të mosdisponueshmërisë apo papërshtatshmërisë të hapësirës së kabinetit, produkti nuk do të mund të vihet në dispozicion. Çdo refuzim i tillë do të shoqërohet me një arsyetim për refuzimin dhe me kërkesë të përfituesit të mundshëm t'i mundësohet edhe organit rregullator AKEP.

3.1.8. Kushtet për kërkuarin e aksesit për të inspektuar vëndet në të cilat ofrohet aksesit në rrjetin lokal ose vëndet e aksesit në rrjetin lokal janë refuzuar me arsyetimin e mungesës së kapacitetit të cilat nënvizohen në Manualin e Proçeseve për aksesin në rrjetin lokal.

- 3.1.9. I gjithë stafi i kërkuesit të aksesit, përpara se të lejohet të ketë akses në ndonjë kabinet të ONE Albania me qëllimin e ofrimit të shërbimeve të aksesit do të kërkohet të regjistrohet në përputhje me parashikimet e Manualit të Proçeseve për aksesin në rrjetin lokal.
- 3.1.10. Kërkuesi i aksesit do të sigurojë që i gjithë stafi i tij të jetë në përputhje me kërkesat të sigurisë siç kërkohet nga ONE Albania.
- 3.1.11. Kërkuesi i aksesit do të pajtohet dhe do të sigurojë që i gjithë stafi i aksesit do të përputhet me rregulloret për shëndetin dhe sigurinë siç kërkohet nga ONE Albania dhe specifikuar në Proçedurat për Sigurinë dhe shëndetin bashkëngjitur në Shtojca 2. Aty ku ky dokument referon hapësirat e ONE Albania duhet të lexohet si referuar kabineteve.
- 3.1.11.1. Dështimi nga stafi i kërkuesit të aksesit për të qenë në përputhje me Proçedurat e Sigurisë dhe Shëndetit siç janë nënvizuar në Manualin e Proçeseve për aksesin në rrjetin lokal do të jetë subjekt i Marrëveshjes së Aksesit.
- 3.1.12. Të gjitha akseset në kabinetet e ONE Albania do të jenë të shoqëruar dhe në përputhje me termat e Manualit të proçeseve për aksesin në rrjetin lokal.
- 3.1.13. ONE Albania do të ofrojë shërbimin e aksesit në rrjetin lokal në përputhje me termat e Marrëveshjes së Aksesit.

4. Koha e Lëvrimit

- 4.1. Kohët e lëvrimit do të jenë sipas përcaktimeve në Manualin e Proçeseve për aksesin në rrjetin lokal.

5. Struktura e pagesave

- 5.1. Pagesat apo mënyrat e pagesave (faturimit) për aksesin në rrjetin lokal do të jenë sipas përcaktimeve në Listën e Çmimeve të RUO të ONE Albania, përfshirë pagesat për Kategorizimin e Linjës.

SHTOJCA 1

I SKEDËS SË SHËRBIMIT 104

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT PËR AKSES NË RRJETIN LOKAL- MSAN

Përmbajtja:

1. Hyrje
2. Përshkrimi i shërbimit
3. Elementët e produktit
 - 3.1. Fasilitetet e lidhjes në kabinet
 - 3.2. ULMP (aksesi i plotë) me aksesin në rrjetin lokal- MSAN
 - 3.3. Line sharing (aksesi i përbashkët) me aksesin në rrjetin lokal-MSAN
 - 3.4. Ambjentet e klientit
4. Mos disponueshmëria e shërbimit
5. Menaxhimi i shërbimit
 - 5.1. Porosia
 - 5.2. Riparimi i difekteve

1. Hyrje

Në këtë pjesë përcaktohet përshkrimi i shërbimit teknik për të mbështetur aksesin në rrjetin lokal-MSAN.

Proçesi dhe detajet teknike që mbështesin implementimin e shërbimit do të nënvizohet në Manualin e Proçeseve ndërmjet operatorëve dhe Manualin Teknik për aksesin në rrjetin lokal-MSAN që do të zhvillohet nga industria.

Të gjitha pajisjet dhe impiantet të instaluar si pjesë e implementimit të shërbimit do të jenë në përputhje me standartet përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare. Të gjitha procedurat e instalimit duhet të jenë në përputhje me praktikatat më të mira të industrisë.

2. Përshkrimi i shërbimit

Një qark aksesi në rrjetin lokal-MSAN konsiston në një qark që ofron një rrugë transmetimi të një linje metalike dypercjellëse mes ambjenteve të pajtimtarit të shërbyer dhe një xhunto nëntokësore e lidhur me një pikë lidhjeje aksesi në rrjetin lokal-MSAN brënda rrjetit të ONE Albania. Xhuntoja ofron një pikë ndërfaqeje mes rrjetit të ONE Albania dhe rrjetit të kërkuesit të aksesit.

Pika e lidhjes së aksesit (LCP) në rrjetin lokal-MSAN përkufizohet si street side distribution copper cabinet (kabineti).

Linja e bakrit e ofruar do të lejojë kërkuesin e aksesit të vendosë pajisjet përkatëse në mënyrë që t'i ofrojë pajtimtarit shërbimet e komunikimeve elektronike. Të gjitha pajisjet e vendosura nga kërkuesi i aksesit duhet të jenë në përputhje me Planin e Menaxhimit të Frekuencave të Linjës së bakrit.

ONE Albania do të jetë përgjegjës për ofrimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e qarkut të aksesit në rrjetin lokal-MSAN.

3. Elementët e produktit

3.1. Fasilitetet e lidhjes në kabinet

Për të siguruar që pajisjet e kërkuarit të aksesit, të vendosura aty ku është akomoduar kërkuari i aksesit të mund të lidhen në Pikën e Lidhjes të aksesit në rrjetin lokal brenda rrjetit të aksesit të ONE Albania, propozohet si më poshtë:


ONE Albania do të caktojë një pusetë për shërbimin LCP (pika e Lidhjes në rrjetin lokal). Kërkuari i aksesit do të ndërtojë ose do të bie dakort të përdorë një pusetë të ndërtuar të kërkuarit të aksesit brenda një distance të arsyeshme me pusetën e ONE Albania, e cila nuk do të çënojë shërbimin ekzistues PSTN për produktin e aksesit të përbashkët (line sharing). Kërkuari i aksesit do të ndërtojë një tubacion (tubacioni A) mes dy pusetave dhe ONE Albania do të ofrojë një pikë hyrjeje për tubacionin e kërkuarit të aksesit në pusetën e ONE Albania të caktuar për shërbimin LCP.

Kërkuari i aksesit është përgjegjës për të gjitha lejet dhe servitutet në lidhje me pusetat dhe tubacionet përkatëse.

Kërkuari i aksesit do të mundësojë më pas dhe ONE Albania do të instalojë dhe terminojë një kabëll lidhës për aksesin në rrjetin lokal mes LCP të ONE Albania dhe xhuntos nëntokësore brenda pusetës së kërkuarit të aksesit. Kablli lidhës për aksesin në rrjetin lokal do të terminohet në LCP në stricën e kabllit të kërkuarit të aksesit.

Të gjitha kabllo lidhës për aksesin në rrjetin lokal duhet të jenë në përputhje me specifikimet e dhëna në Shtojca 1 në mënyrë që të mënjanojnë interferencat. Kablli lidhës duhet të ofrohet si kabëll 50 kopjesh, psh nëse kërkohen 100 kopje, kërkuari i aksesit do të vërë në dispozicion 2 kablllo 50 kopjesh.

Do të jetë përgjegjësia e kërkuarit të aksesit për të vënë në dispozicion një kabëll të dytë lidhës nga xhuntoja e dytë nëntokësore brenda pusetës së kërkuarit të aksesit për t'i lidhur tek pajisjet e tyre. Diagrama e mëposhtme ilustron një shembull të saj brenda rrjetit.



3.2. ULMP me aksesin në rrjetin lokal-MSAN

Linja lokale e bakrit është një çift linje dypërcjellëse bakri që mundëson një lidhje nga Pika e Lidhjes në rrjetin lokal dhe njësisë terminale të rrjetit (NTU) në ambjentet e klientit, ose në një pikë terminale të rrjetit (NTP) ku nuk ekziston një NTU.

Pikat e demarkacionit do të jetë strica e kërkuesit të aksesit në Pikën e Lidhjes (LCP) dhe njësisë terminale e rrjetit (NTU) në ambjentet e pajtimtarit, ose pika terminale e rrjetit (NTP) ku NTU nuk ekziston. Një PQO i ONE Albania do të ofrojë akses në LCP për kërkuesin e aksesit.

